

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7860 E martë 23 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga BERNARD HENRI-LEVY

Odë për Zonjën Tonë të Europës



Teksa e shkruaj këtë nga Berlino, jam zemërthyer përpara imazhit të zjarrit, shkatërrimit dhe të hirit që del nga Katedralja Notre-Dame e Parisit - Zonja Jonë e Parisit ...
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga SPARTAK NGJELA

Targeti rus për Shqipërinë është shumë i vështirë



Shqipëria është në një periudhë të veçantë historike, për të tani ngrihen këto pyetje: 1. A do ta çojë ajo deri në fund Reformën në Drejtësi, e cila është strukturuar...
Vijon në faqen 21



Ndihmuan grabitësit e Rinasit, 4 në pranga. Në kërkim i arratisuri nga burgu i Trikalës

2 veta lyen furgonin, 2 të tjerë ndihmuan largimin e autorëve me një makinë tjetër

TIRANË-Goditet grupi i strukturuar kriminal që realizoi megagrabitjen në pistën e aeroportit të Rinasit mesditën e 9 prillit. 13 ditë pas kësaj ngjarjeje të rëndë, policia ka arrestuar 4 persona, të cilët dyshohen se bashkëpunuan me Admir Muratajn, që mbeti i vrarë me një plumb në kokë gjatë grabitjes spektakolare. Në pranga kanë përfunduar shtetasit ...
Në faqet 2-3

EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA NDERTIMET PA LEJE, KUSH MERR PARATE PER TRUALLIN

KOMPENSIMI I PRONAVE, 540 FAMILJET QE MARRIN PARATE

Përfituesit në Tiranë dhe në rrethe. Agjencia e Trajtitimit të Pronave: Dokumentet që nevojiten, formulari, karta e identitetit dhe llogaria bankare aktive



(Në foto) Zonë informale në Tiranë

Në faqen 7

BASHA ME ALEATET

Opozita, protestë më 11 maj. Plani i ri i PD, bllokim rrugëve në çdo qytet
Në faqen 5

ISH-MINISTRI I JASHEM

Bushati "kundër" Ramës: Jo neglizhim vendimit të Holandës për vizat 'Shengen'
Në faqen 6

"30 QERSHORI"

Sot skadon afati në KQZ, cilat janë 34 partitë që do hyjnë në zgjedhje
Në faqen 6

INTERVISTA

16-vjeçarja nga Shqipëria: Si u prit kënga ime në "Sanremo Junior"
Në faqen 14

OPOZITA



Partia e re, Patozi mbledh mbështetësit. Sot zyrtarizimi i "Bindjes Demokratike"
Në faqen 4

Elbasan/ Komplikacionet, familjarët pretendojnë se kardiologu u vonua

Vdes gruaja pas lindjes, pranga 2 mjekëve

25-vjeçarja ndërron jetë, spitali: Foshnja gëzon shëndet të plotë

Një ngjarje e rëndë u regjistrua sot në Elbasan. Një 25-vjeçare humbi jetën ndërsa sollti në jetë fëmijën e saj të parë në maternitetin e këtij qyteti. 25-vjeçarja nga fshati Katund i Ri, dyshohet të ketë pësuar një arrest kardiak pas lindjes, ç'ka i mori asaj jetën, ndërsa



fatmirësisht foshnja gëzon shëndet të plotë. Familjarët e 25-vjeçares, të pranishëm në maternitetin e Elbasanit, akuzojnë mjekët për pakujdesi. Sipas tyre, pas përkeqësimit të gjendjes së saj shëndetësore, gjinekologu ka kërkuar ndihmë nga kolegët ...
Në faqen 9

GRABITJA NE RINAS ARRESTIMET

4 të arrestuarit, miq e të afërm të kapove të grupeve kriminale

Lidhjet mes 3 grupeve në grabitjen e Rinasit, si u bënë bashkë Kupa, Murataj dhe Çala

Të tre u arratisën së bashku nga burgu i Trikallas, në marsin e vitit 2013

TIRANË

Në grabitjen e 9 prillit në pistën e aeroportit të Rinasit u përfshinë tri grupe kriminale, bashkëpunimi mes të cilëve origjinën e ka në Greqi. Admir Murataj, i vrarë në grabitjen e fundit, Klement Çala dhe Ilir Kupa u arratisën së bashku nga burgu i Trikallas, në marsin e 2013. Sipas TV "Klan", mësohet se pasi u vendosën në Shqipëri, ata vazhduan të kishin të njëjtin aktivitet kriminal, duke kryer disa nga grabitjet më spektakolare. Çala është në kërkim si bashkëpunëtor i Aleks Pepës, i cili hyri në pistën e Rinasit në 10 qershor të 2016 për të grabitur një tjetër shumë të konsiderueshme eurosh. Ai gjithashtu dyshohet se është i përfshirë në dy grabitjet në 2015-ës së bashku me Admir Muratajin. Në atë kohë, ata sulmuan blindat e kompanive të sigurimit, duke u arratisur pa lënë asnjë gjurmë pas. Grupi i Ilir Kupës u njoh nga autoritetet shqiptare si banda e "bagajshëve". Një e pjesë anëtarëve të këtij grupi u dënuan nga gjykatat, ndërsa personave të tjerë nuk u provua pjesëmarrja në këto ngjarje, por që kishte informacione që ata ishin pjesë e tyre. Pas kthimit në Shqipëri, personi më aktiv në disa grabitje milionare eurosh ishte Admir Murataj. Në 3 grabitje ku ai mori pjesë arriti të vjedhë rreth 10 milionë euro. Pjesa më e madhe grupeve të tij u arrestuan dhe u dënuan nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Megjithatë, ai nuk u prangos së bashku me disa anëtarë të tjerë, të cilët dyshohet se ishin grupi i zjarrit që sulmonin blindat me para. Në grabitjen e 9 shkurtit 2017 mori pjesë edhe Dash Kupa dhe vëllai i tij, Everesti. Sipas prokurorisë, ata kishin në pronësi një piceri në Fushë-Krujë dhe aksioner në



Admir Murataj



Klement Çala

këtë biznes sipas ekstraktit të nxjerrë nga QKB është Ermal Veseli, i vëllai i Oltion Veselit, i arrestuar për grabitjen e fundit. Oltion Veseli, i arrestuar në Krujë, nuk duket se ka lidhje fare rastësose me këtë grabitje apo me sulmet që u janë bërë blindave me para në të shkuarën. Oltion Veseli është i afërm i Dash Kupës, grabitësit të blindave me para në 2015-ën. Ndërsa, personi i cili për vite qëndroi në hije në vendin tonë pas kthimit nga Greqia ishte Klement Çala. Ai u detyrua se mori pjesë në grabitjet e Qafë-Kasharit, por asnjëherë nuk pati ngjarje akuzash për të. 31-

vjeçari u arrestua në vitin 2015 në Vlorë për armëmbajtje pa leje, së bashku me Alkond Bengasin (njihet si mik i ngushtë i Çalës), një tjetër nga të ndaluarit për grabitjen e fundit në Rinas. Ky i fundit ka pak kohë që ka dalë nga burgu, pasi ka vuajtur dënimin me tri vite heqje lirie për veprën penale, "prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike". Por, Gjykata e Vlorës në fund vendosi ta dënonte me 4 vite shërbim prove, edhe pse ai kërkoi nga autoritetet greke në atë kohë për arratisjen nga burgu. Sipas burimeve policore, Saimir Çela

SAIMIR ÇELA

28-vjeçari nga Elbasani, Saimir Çela është një person me precedentë të mëparshëm penalë. Mësohet se Çela ka qenë shoqëruar edhe për grabitjen e pikës së këmbimit valutor në Fier, ku mbeti i vrarë Agur Vrenozi pas përleshjes me grabitësit, por ai u lirua sërisht, pasi policia nuk gjeti prova për ta lidhur me tre autorët Zini Fryraj, Lulëzim Demiraj dhe Dashamir Gergali.

ALKOND BENGASI

34-vjeçari nga Elbasani, Alkond Bengasi, i njohur si mik i Klement Çalës nuk është i panjohur për drejtësinë shqiptare. Ai ka pak kohë që ka dalë nga burgu, pasi ka vuajtur dënimin me 3 vite heqje lirie për veprën penale, "prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike". Për herë të fundit, Bengasi është arrestuar në vitin 2015 së bashku me Klement Çalën në Vlorë teksa ishin me pushime.

është një person me precedentë të mëparshëm penalë. Mësohet se ai ka qenë shoqëruar edhe për grabitjen e pikës së këmbimit valutor në Fier, ku mbeti i vrarë Agur Vrenozi pas përleshjes me grabitësit, por ai u lirua sërisht, pasi policia nuk gjeti prova për ta lidhur me tre autorët Zini Fryraj, Lulëzim Demiraj dhe Dashamir Gergali. I vetmi që nuk ka dosje hetimore është Renaldo Sulaj. Sipas hetuesve, personat që kanë mbetur të lirë nga 3 grupet e mësipërme janë bërë bashkë për të kryer ndoshta grabitjen më të madhe të ndodhur në Shqipëri.



Hyrja

Grabitja

OLTION VESELI

38-vjeçari Oltion Veseli nga Kruja është i afërm i Dash Kupës, grabitësit të blindave me para në vitin 2015. Mësohet se familjarë të tij dhe Dash Kupa janë ortakë në biznese shërbimi. Sipas prokurorisë, ata kishin në pronësi një piceri në Fushë-Krujë dhe aksioner në këtë biznes sipas ekstraktit të nxjerrë nga QKB-ja është Ermal Veseli, i vëllai i Oltion Veselit, i arrestuar për grabitjen e fundit.

SHKURTE

I vendoset tritol makinës së parkuar në oborrin e shtëpisë

TIRANË - Një sasi lënde plasëse është vendosur në orët e para të mëngjesit të djeshëm në pjesën e pasme të një mjete në Yrshek të Tiranës. Nga të dhënat e para raportohet vetëm për dëme materiale. Mësohet se makina të cilës iu vu tritol në Yrshek është në pronësi të Lulëzim Çikës, babait të policit Julian Çika. Ky i fundit është polic qarkullimi në Tiranë. "Rreth orës 04:00 të mëngjesit, në Yrshek, në oborrin e banesës, në pjesën e pasme të mjetit në pronësi të shtetasit L.Ç., ka shpërthyer një sasi e vogël lënde e dyshuar plasëse. Shërbimet e policisë po punojnë për identifikimin dhe kapjen e autorit", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

I gjenden pistoletë dhe fishekë, fieraqja kapet në Kakavijë

GJIROKASTËR - Një 45-vjeçare është arrestuar ditën e djeshme nga policia Kufitare në Kakavijë, pasi iu gjet një pistoletë pa leje. Mësohet se arrestimi i 45-vjeçares me iniciale L.S., banuese në Fier, erdhi pas një kontrolli në automjetin e përdorur prej saj, ku në bagazh iu gjet e fshehur një armë zjarri e llojit "Glock". Pas verifikimeve dhe kontrollit të ushtruar në automjet nga punonjësit e Policisë Kufitare në bashkëpunim me shërbimet doganore, në bagazhet e këtij mjete iu gjet e fshehur një armë zjarri e llojit "Glock", kalibri 9 mm, me gjithsej 9 fishekë. Veprimet hetimore dhe procedurale të mëtejshme u kryen nga specialistët e Postës së Policisë Dropull, të cilët bënë arrestimin në flagrancë të shtetasës L.S., për veprën penale "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit", thanë burimet policore.

Zbardhet plagosja e Mëzezit, shpallen në kërkim 3 persona

TIRANË - Policia ka zbardhur ngjarjen e ndodhur dy ditë më parë, ku në Mëzëz afër Kasharit u plagos me armë zjarri një 28-vjeçar. Për këtë, policia ka identifikuar dhe shpallur në kërkim tre persona, të cilët dyshohen si të përfshirë në ngjarje. "Pas ditën e së dielës në Fushë-Mëzëz, Kashar, mbeti i plagosur shtetasi me iniciale E.M., i cili fatmirësisht ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën. Nga veprimet hetimore të kryera rezultoi se në mjetin që drejtohe autorit i dyshuar shtetasi M. G. ndodheshin edhe shtetasit A. M., 29 vjeç dhe E. G., 35 vjeç, të cilët janë shpallur në kërkim për veprën penale "Përkrahje e autorit në krim". Materialet iu referuan për veprimet të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë", njoftoi policia.



Kapja e 4 personave, Rama: Sa më shumë baltoset policia, aq më shumë godet

TIRANË - Pas ndalimit të katër personave, të cilët dyshohen si të implikuar në grabitjen e parave në aeroportin e Rinasit, ka reaguar edhe kryeministri Rama. Sipas shefit të qeverisë, ndalimi i tyre është një zhvillim inkurajues, i cili më pas do t'i hapë rrugë arrestimit të të gjithë personave të tjerë për ngjarjen e 9 prillit. Ai nuk harroi të shigjetonte edhe kritikët e Policisë së Shtetit, ndërsa pohoi se sa më shumë baltë të hidhet drejt tyre, kjo e fundit duhet të japë përgjigjen duke rritur forcën e saj goditëse ndaj kriminit. "Ndalimi i 4 personave të përfshirë në grabitjen e aeroportit, një zhvillim inkurajues në rrugën e ndalimit dhe ndëshkimit ligjor të të gjithë autorëve të kriminit. Policia e Shtetit duhet të provojë përditë se sa më shumë sulmohet e baltoset, aq më shumë rritet forca e saj goditëse", thekson Rama. Alkond Bengasi, Saimir Çela, Renaldo Sula nga Elbasani dhe Oltion Veseli nga Fushë-Kruja dyshohen si të përfshirë në ngjarje, fill pas së cilës gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë mbeti i vrarë Admir Murataj, një ekspert i botës së kriminit.

TIRANË

Goditet grupi i strukturuar kriminal që realizoi megagrabitjen në pistën e aeroportit të Rinasit mesditën e 9 prillit. 13 ditë pas kësaj ngjarjeje të rëndë, policia ka arrestuar 4 persona, të cilët dyshohen se bashkëpunuan me Admir Murataj, që mbeti i vrarë me një plumb në kokë gjatë grabitjes spektakolare. Në pranga kanë përfunduar shtetasit: Alkond Bengasi, 34 vjeç; Renaldo Sula, 25 vjeç dhe Saimir Çela, 28 vjeç, të tre banues në Elbasan, si dhe 38-vjeçari Oltion Veseli, banues në Krujë. Mësohet se këta persona u prangosën gjatë një operacioni të ndërmarrë të dielën nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda si dhe blutë e Tiranës, Elbasanit dhe Durrësit. Alkond Bengasi, Saimir Çela, Renaldo Sula nga Elbasani dhe Oltion Veseli nga Fushë-Kruja dyshohen si të përfshirë në ngjarje, fill pas së cilës gjatë shkëmbimit të zjarrit me policinë mbeti i vrarë Admir Murataj, një ekspert i njohur i botës së kriminit. Të gjithë të arrestuarit dyshohen se kishin rolin e bashkëpunëtorëve dhe ndihmësve. Në duart e policisë nuk është asnjë prej personave që shpërthyen rrethimin e aeroportit dhe ekzekutuan supergrabitjen. Ndërkohë që janë shpallur në kërkim Klement Çala dhe vëllai i tij, Eldi Çala si dhe dy persona të tjerë. Klement Çala njihet për lidhjen miqësore me Admir Murataj, pasi u arratisën së bashku nga burgu i sigurisë së lartë në Trikalë të Greqisë në 2013. Përgjimet telefonike ndihmuan hetuesit të drejtonin sytë nga ekspozentë të botës së kriminit në Elbasan dhe të binin në gjurmët e një servisi. Në këtë servis që ndodhet në rrugën e vjetër Elbasan-rrerrotullimi i Bradasheshit, dyshohet të jetë modifikuar automjeti tip "Volskwagen" me mbishkrimin "hetimi tatimor", që u përdor në megagrabitjen e 9 prillit në pistën e aeroportit. Përgjatë ditëve të fundit, grupi hetimor ka marrë dëshmitë e dhjetëra personave, mes tyre të afërm të Admir Muratajt e Klement Çalës. Por, ndonëse grupi është goditur, deri më tani nuk janë gjetur paratë e grabitura, ndërsa mbetet e paqartë nëse 47-vjeçari Murataj është ekzekutuar nga policia apo miqtë e tij gjatë shkëmbimit të zjarrit. Policia sqaron se janë përdorur teknika speciale hetimi mes tyre përfshijë përgjimet, vëzhgimet në terren si dhe hapjen e dosjeve të vjetra mes të cilave rezultojnë të përfshira grupet e Admir Muratajt dhe Ilir Kupës, i njohur edhe si kreu i 'babagjyshave' grabitës.

ROLI I PERSONAVE TË ARRESTUAR

Ndërsa orët kalojnë, rrethi i të përfshirëve në supergrabitjen e Rinasit sa vjen e bëhet më i madh. Përveç 4 personave të arrestuar, dyshohet të jenë edhe të paktën 4 të tjerë që kanë ndihmuar në organizimin e saj. "Gazeta Shqiptare" ka zbërthyer edhe

2 të tjerë ndihmuan grabitësit të largoheshin nga vendi i ngjarjes me një furgon të dytë

Megagrabitja në aeroportin e Rinasit, përfundojnë në pranga 3 persona nga Elbasani e 1 nga Kruja

Operacioni në Tiranë, Elbasan e Durrës. 2 nga të arrestuarit modifikuan në servis makinën me logon "Hetimi Tatimor"



3 nga 4 personat e arrestuar për grabitjen në Rinas

PERSONAT E

1. Alkond Bengasi, 34 vjeç nga Elbasani
2. Renaldo Sula, 25 vjeç nga Elbasani
3. Saimir Çela, 28 vjeç nga Elbasani
- Oltion Veseli, 38 vjeç nga Kruja

ELBASAN - Detaje të reja janë zbuluar në lidhje me supergrabitjen e Rinasit, të ndodhur më 9 prill në pistën e aeroportit të Rinasit, ku dyshohet se u morën rreth 10 mln euro. "Nwes 24" dhe "GSH" kanë mundur të kontaktojnë me telefon pronarin e servis "Genti", që ndodhet në rrugën e vjetër Elbasan-rrerrotullimi i Bradasheshit, aty ku dyshohet se u modifikua enkas për grabitjen furgoni me mbishkrimin "Hetimi Tatimor". Pronari i servisit, shtetasi Gentian Sharra, ka konfirmuar se servisin ia kishte dhënë me qira shtetasit Eldi Çala. "Nuk kisha shumë punë dhe ia dhashë me qira shtetasit Eldi Çala. Nuk kisha kontratë materiale me të, pasi servisi ishte në proces le-

Servisin e kishte vëllai i "mjeshtrit" të grabitjeve, Çala

Pronari i servisit ku u modifikua furgoni me mbishkrimin "Hetimi Tatimor": E dhashë me qira



galizimi. Nuk kam dijeni për aktivitetin e paligjshëm që është kryer në këtë servis", ka thënë ai. Ky servis, i cili është i kyçur tashmë, konsiderohet provë materiale për prokurorinë dhe policinë. Po ashtu, edhe një

lokal ngjitur me servisin, shumë i populluar me herët është boshatisur dhe brenda tij mund të gesh vetëm një kamerë, i cili thotë se nuk ka dijeni për ngjarjen. Ndërkaq, Eldi Çala rezultoi të jetë vëllai i Klement Çalës, i etiketuar si "ekspert i grabitjes" së bankave dhe i shpallur në kërkim nga Policia e Shtetit në lidhje me ngjarjen e 9 shkurtit 2017, ku u grabitën blindat me 3.2 milionë dollarë të bankave të nivelit të dytë në aksin Qafa e Kasharit-Rinas. 31-vjeçar është një emër i njohur për autoritetet shqiptare dhe greke. Ai është një emër i njohur; sidomos pas grabitjes së

famshme të Bankës Kombëtare Greke në qendër të qytetit të Larisës. Klement Çala rezultoi të jetë arratisur së bashku me Admir Murataj nga burgu i Trikalasë më 22 mars 2013. Çala ishte identifikuar si autor i plagosjes së një efektiv të policisë greke dhe vrasjes së një qytetareje të pafajshme gjatë shkëmbimit të zjarrit me trupat e policisë. Policia greke kishte gjetur gjurmë ADN-je të Klement Çalës në furgonin e bardhë të vjedhur në Korinth, me të cilin të arratisurit nga burgu i Trikalasë.

rolin që kishin 4 personat e prangosur: Alkond Bengasi, Renaldo Sula, Oltion Veseli dhe Saimir Çela. Dy prej të ndaluarve dyshohet të kenë punuar për modifikimin e furgonit, me të cilin u krye supergrabitja. Ata e kanë modifikuar në pjesën e përparme dhe i kanë ndryshuar

ngjyrën, e kanë lyer me të bardhë si dhe i kanë vënë mbishkrimin "Hetimi Tatimor". Dy personat e tjerë Oltion Veseli nga Fushë-Kruja mësohet të ketë ndihmuar grabitësit të largohen nga vendi i ngjarjes me një furgon të dytë. Po ashtu, edhe personi i katërt i përfshirë në gra-

bitje është nga Fushë-Kruja dhe dyshohet të ketë ndihmuar në grabitje. Një nga të rejat e tjera të zbuluara është fakti se është kërkuar ndihmë nga autoritetet greke dhe ato kosovare, pasi dyshimet janë se lëvizte mes Tiranës e Prishtinës dhe kthehej në një bazë në Elbasan dhe një tjetër

në Tiranë, diku në zonën e "Freskut". Pritet po ashtu me interes, zbardhja e dëshmisë së të ndaluarve, se kush ua solli furgonin për modifikim? Si u punësuan disa prej tyre në këtë servis? Ka pasur të shoqëruar edhe persona të tjerë, të afërm të Klement Çalës që janë marrë në pyetje.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të I (Pare), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Garazh, me sip. 96 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 19932-G3, Vol. 45, Fage 169, ndodhur në Linzë Dajç, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë "AGL" sh.p.k identifikuar me NIFP: J71702004M. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 1.893.120 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet) LEKE.

Ankandi do të zhvillohet më datë 26.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr. telefon 042320227, email: elvinit@hotmail.com. Ankandi të publikohet nga data 22.04.2019 deri më 26.04.2019

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Përbarimorë L.D.C

- Nr. pasurie 50/1, ZK Virua, vol 1, fq.27, Tual me sip. 240.47 m² + ndërtesë me sip. 240.47 m², Regjistruar në ZVRPP Gjrokastrer në emër të Fatos Çela. Çmimi fillestar për shitje është 3.445.600 Leka.

- Nr. pasurie 190/84, ZK 2647, vol 2, fq.247, Tual me sip. 300 m² + ndërtesë një katëshe me sip. 88 m². Regjistruar në ZVRPP Tepelene në emër të Votim Çela. Çmimi fillestar për shitje është 1.064.000 Leka. Data e shpalljes 09.04.2019 Data e zhvillimit 08.05.2019 deri në orën 16.00 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Përbarimorë L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila B/1, kati 1 Tiranë.

AKSIONI I OPOZITËS PROTESTAT

"Bindja Demokratike" regjistrohet sot në gjykatë e KQZ, emrat e bordit drejtues

Patozi në krye të "Bindja Demokratike", Hajdari kërkon më tepër kohë

"Hapësirë për demokratizim. Nuk e drejtojmë"

Valentina Madani

Forca më e re politike, "Bindja Demokratike", tashmë ka gati 3000 firma për t'u regjistruar në Gjykatën e Tiranës. Procedura ligjore pritet të formalizohet paraditen e sotme, që përkon edhe me afatin e fundit të regjistrimit të partive politike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për garën elektorale të 30 qershorit. Partia e re nuk e ka zyrtarizuar ende kryetarin e saj. Por, mësohet se ajo do të drejtohet nga ish-nënkryetari i Partisë Demokratike, Astrit Patozi. Rudina Hajdari, që mendohej se do të ishte pjesë e kësaj partie politike, mësohet se është tërhequr për kohësisht nga ky projekt. Deputetja që kryeson grupin e ri demokrat në parlament pati një takim me Patozin të enjten dhe të shtunën e kaluar për të diskutuar mbi detajet e grupimit të ri politik, por sipas TV "Klan" në momentin final, ajo ka hezituar për të qenë në krye të partisë dhe ka kërkuar më tepër kohë. Këtë qëndrim, deputetja Hajdari e ka përforcuar përmes një statusi në rrjetet sociale, ku pohon se nuk do të jetë në krye të kësaj partie dhe se angazhimi kryesor për të është kryesimi i grupit parlamentar demokrat në parlament. Por, Hajdari përshëndet krijimin e çdo forumi të ri politik, të cilin e sheh si një hapësirë më shumë për demokratizimin e politikës dekadente, që sipas saj ka përfshirë vendin. Teksa pritet zyrtarizimi i emrit të kryetarit, "Bindja Demokratike" ka formalizuar bordin e saj, në të cilin bëjnë pjesë ish-anëtarë të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, si Leonard Olli, Fabian Topallaj, apo dhe Ardian Kollozi. Astrit Patozi njihet si një ndër zërat më kritikë ndaj Lulzim Bashës. Ai ndërromori pak kohë më parë edhe një vizitë për "Ringritjen e Partisë Demokratike", që synonte demokratizimin e kësaj force politike.

DEKLARATA
Rudina Hajdari mohan përpjekjet për krijimin e një partie të re. Përmes një postimi në "Facebook", ajo shprehet se vetë nuk ka bërë asnjë



Ish-nënkryetari i Partisë Demokratike, Astrit Patozi dhe deputetja Rudina Hajdari

Partia e re? Bushati: Jam e fokusuar në karrierën akademike

Partia e re "Bindja Demokratike" pritet të regjistrohet në gjykatë, ndërsa në media është përfolur se pjesë e bordit drejtues është edhe ish-kryetarja e AMA-s, Endira Bushati, një kritike e hapur e kreut demokrat, Lulzim Basha. Bushati në një reagim në rrjetet sociale shprehet se pavarësisht pretendimeve, ajo po sheh karrierën e saj profesionale e akademike. Ajo mohon që të jetë pjesë e bordit drejtues të partisë së re që pritet të drejtohet nga Astrit Patozi. "Për shumë kohë kam folur e shkruar mbi median dhe rolin e saj në Shqipëri, për mënyrën se si 'shiten' lajme pa u verifikuar dhe pa më të voglën etikë profesionale. Ka rreth 2 orë që gazetarë, kolegë e miq, më njoftojnë se unë qenkam 'themeluese' e një partie... Nuk po u vaj për një arsye të thjeshtë: është e



vërtetë që unë jam shprehur kundër mënyrës së drejtimit të PD-së nga Lulzim Basha... Vazhdoj t'u qëndroj të gjithave çfarë kam thënë që pas humbjeve të zgjedhjeve të 2017! Dhe kam pasur bindjen, që herët a vonë vakumi i krijuar në frontin opozitar do të plotësohej me forca të tjera

deklaratë e nuk ka marrë një iniciativë të tillë, pavarësisht se është në kontakt me demokratë në mbarë vendin. "Krijimi e çdo forumi të ri politik e shikoj si një hapësirë më shumë, për demokratizimin e politikës dekadente, që ka përfshirë vendin dhe gjithsecilit i uroj rrugëtim të mbarë dhe suksese në përpjekjet e tij", - shprehet zj.Hajdari.

Deputetja shkruan se shqiptarët janë të lodhur e shqetësuar nga politika e dëshmtme 28-vjeçare e për pasojë "krijimi i një alternative të re, të vërtetë dhe shpresëdhënëse që ka për qëllim interesin publik, përfaqësimin qytetar dhe një politikë bërëje të re me standarde përëndimore do të ishte një iniciativë për t'u gëzuar". Hajdari risjell në vëmendje

BOJKOTI

PLL vendosi dje që të mos futet në zgjedhjet e 30 qershorit. Kreu Shpëtim Axhami tha se nuk do të bëhen pjesë e zgjedhjeve pa u siguruar vota dhe plotësuar kushtet e vendosura nga opozita. "Jemi në mbështetje të aksionit politik që kryetari i opozitës së djathtë ka ndërmarrë, duke gjetur mbështetjen e të gjithë elektoratit tonë dhe më gjerë", thuhet në mesazhin e z.Axhami.



Një nga protestat e fundit të opozitës

Motra e mbretëreshës Geraldinë takon presidentin

Meta: Ndërtimet pa kritere, një regres që duhet të marrë fund

Presidenti Ilir Meta në Ditën Ndërkombëtare të Tokës kërkoi dje një kujdes më të shtuar për të mbrojtur mjedisin dhe ekosistemin. Në një postim në "Facebook", kreu i shtetit shkruan se duhet të marrë fund regresi i ndërtimeve pa kritere në kurorat e gjelbra. "Për një të ardhme më të shëndetshme të fëmijëve tanë, është detyra jonë ta mbrojmë tokën, shtëpinë tonë të përbashkët, duke treguar një kujdes e vëmendje më të shtuar për mjedisin dhe ekosistemin, ruajtjen e biodiversitetit të pasur dhe pyjeve të bukura të Shqipërisë. Mbrojtja e tokës dhe e mjedisit nuk duhet trajtuar si propagandë mediatike! Të gjithë jemi dëshmitarë se si kurorat e gjelbra, që duhet të ishin mushkëria e pacenueshme e qyteteve tona, fatkeqësisht janë dëmtuar nga ndërtimet pa kritere, një regres që duhet të marrë fund! Ta bëjmë tokën një vend më të mirë për të jetuar!", deklaroi z.Meta. Po dje, Presidenti i Republikës priti në zyrën e tij, motrën e mbretëreshës Geraldinë, Sylviane Muselier. Kreu i shtetit shprehet se sot Tirana duket edhe më e bukur, ndërsa thekson se dashuria e saj dhe ndihma e dhënë për Shqipërinë do të mbetet gjithmonë një burim frymëzimi. "Tirana sot duket më e bukur nga vizita e një zonje të jashtëzakonshme, Sylviane Muselier, motra e "Trëndafilët të bardhë", mbretëreshës Geraldinë. Dashuria e saj e madhe për Shqipërinë, e konkretizuar edhe me ndihma humanitare e mjekësore për fëmijët e njerëzit në nevojë, mbetet përherë një burim frymëzimi. Shumë i lumtur të dëgjoja nga miqtë e saj francezë se nderimi i figurës së mbretëreshës Geraldinë vijon të inkurajojë francezët dhe europianët të ndihmojnë dhe promovojnë Shqipërinë", - shkruan Meta.



TOPALLAJ: "BINDJA DEMOKRATIKE" HYN NË ZGJEDHJE

Partia më e re, "Bindja Demokratike", do të regjistrohet sot në gjykatë. Lajmi konfirmohet nga Fabian Topallaj, anëtar aktual i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe i njohur si kritik i fortë i Lulzim Bashës. "Bindja Demokratike" do të marrë pjesë në zgjedhje. Unë do të jem anëtar i "Bindjes Demokratike". Po përgatisim dokumentacionin, nesër (sot) e dorëzojmë në gjykatë", - tha zj.Topallaj.

politike... Por (dhe ka një "por" të madhe)... Sado që unë, mund të mbështes apo përkrah, programe, njerëz, projekte... më duhet të sqaroj se aktualisht jam tërësisht e fokusuar në karrierën akademike dhe profesionale", shprehet zj.Bushati.

jashtë sistemit e të gjithë elementëve të korruptuar që vijnë nga bota e krimtimit e që me drejtimin e mazhorancës qeverisëse, e kanë futur vendin në një drejtim pa shpresë dhe të ardhme. "Shqiptarëve u duhet një elitë e re politike dhe ne e konsiderojmë një obligim parësor: përgatitjen e një formule të përshtatshme përfaqësimi politik, në mënyrë

që deputetët dhe të zgjedhurit t'i caktojnë qytetarët dhe jo kryetarët e partive. Ajo që më bën përshtypje në kushtet e "psikiatrisë politike" ku jemi futur është fakti që personalisht, pa dhënë asnjë deklaram apo pa ndër-marrë asnjë iniciativë lidhur me këtë, më cilësojnë si kryesues të një forumi të ri që po krijohet", shprehet zj.Hajdari.



Mbledhja, opionet sesi mund të pamundësohen zgjedhjet, nëse bëhen pa opozitën

Opozita protestë kombëtare në 11 maj, nga e enjtja bllokohen rrugët

Basha: Zgjedhje pa opozitën nuk do të ketë

Valentina Madani

Partia Demokratike intensifikon përpjekjet e saj për rrëzimin e Edi Ramës nga pushteti duke radikalizuar aksionin politik. Demokratët vendosën dje që me datën 11 maj në orën 18:00 të zhvillojnë protestën kombëtare ndërkohë që duke nisur nga Kjo e enjte do të ketë protesta rajonale në akset kryesore kombëtare. Kolegji i kryetarëve të PD-së vendosi gjatë mbledhjes së djeshme që krahas vendimit për të thirrur në 11 maj protestën e katërt masive, protestuesit opozitarë të enjten nuk do të jenë para parlamentit, por do të bllokojnë të gjitha akset rrugore hyrëse në kryeqytet, duke përshkallëzuar aksionin për largimin e Ramës. Këtë të enjte pritet të bllokohen arteriet kryesore të hyrjes në kryeqytet. Bllokimi i rrugëve nuk do të ndodhë në të njëjtën orë kur mazhoranca të mbledhjet në seancë plenare, por pasdite. Burime brenda mbledhjes bëjnë me dije se në fjalën e tij para anëtarëve të Kolegjit e më pas para kryebashkiakëve të djathtë z.Lulzim Basha theksoi se opozita "nuk do të lejojë më që zgjedhjet në Shqipëri t'i organizojë dhe diktojë krimi". Sipas Bashës, zgjedhjet do të mbahen pasi të ndëshkohen hajdutët e votave të 2017. Basha, u ndal të zgjedhjet lokale, të cilat i cilësoi një farsë, për faktin që opozita nuk do të jetë pjesë e saj. Vetëm largimi i kryeministrit Rama, për kreun e opozitës mund t'i hapë rrugë zgjidhjes politike për vendosjen e dialogut me qeverinë e re tranzitore lidhur me masat që duhen marrë për krijimin e kushteve për zhvillimin e tyre. Me kërret e degëve, Lulzim Basha diskutoi edhe për disa nga opionet ses mund të pamundësohen zgjedhjet lokale, nëse ato do të mbahen pa opozitën.

Zgjedhjet do të mbahen pasi të ndëshkohen hajdutët e votave të 2017. Me Edi Ramën dhe me Dakon e Gjinnurin në krah të tij nuk mund të ketë zgjedhje të lira as sot, as mot. Prandaj largimi i tij i hap rrugë zgjidhjes politike që kemi kërkuar ne, opozita e bashkuar dhe legjitime e Shqipërisë, për të hapur dialogun me qeverinë e re tranzitore për masat që duhen marrë për të krijuar kushtet për zgjedhjet. Vetëm zgjedhjet e lira do t'i kthejnë legjitimitetin institucioneve, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk ekziston prej një viti e gjysmë. Gjykata e Lartë nuk funksionon, Prokuroria e

Përgjithshme është e paligjshme dhe kur parlamenti ilegjitim është kthyer në vegël të krimit dhe oligarkisë, që po grabisin dhe shkatërrojnë vendin duke mbjellë mjerim dhe pasiguri kudo. Kolegji i kryetarëve ka vendosur për mbajtjen e protestës kombëtare të 11 majit si "një përballje popullore për të treguar se shqiptarët refuzojnë kategorikisht të vidhen dhe të qeverisen nga krimi". "Faturore do të jetë vetëm e Edi Ramës", deklaroi z.Basha. Ky qëndrim i Bashës vjen pas vendimit që Këshilli Kombëtar mori pak ditë më parë, ku vendosi mosregjistrimin e Partisë Demokratike në KQZ pa u plotësuar kushtet për mbajtjen e një procesi të lirë e të ndershëm dhe në rast të kundërt, selia blu paralajmëroi pamundësimin e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit. Aksionin e opozitës, Basha e diskutoi edhe me kryebashkiakët e djathtë, të cilët i propozuan kryetarit demokrat që të dalë lista e kandidatëve për kryetarë bashkie, në mënyrë që ditën kur të plotësohen kushtet për t'u futur në zgjedhje, elektorati të jetë i njohur me figurat që propozon PD për drejtimin e 61 bashkive të vendit.

Përgjithshme është e paligjshme dhe kur parlamenti ilegjitim është kthyer në vegël të krimit dhe oligarkisë, që po grabisin dhe shkatërrojnë vendin duke mbjellë mjerim dhe pasiguri kudo. Kolegji i kryetarëve ka vendosur për mbajtjen e protestës kombëtare të 11 majit si "një përballje popullore për të treguar se shqiptarët refuzojnë kategorikisht të vidhen dhe të qeverisen nga krimi". "Faturore do të jetë vetëm e Edi Ramës", deklaroi z.Basha. Ky qëndrim i Bashës vjen pas vendimit që Këshilli Kombëtar mori pak ditë më parë, ku vendosi mosregjistrimin e Partisë Demokratike në KQZ pa u plotësuar kushtet për mbajtjen e një procesi të lirë e të ndershëm dhe në rast të kundërt, selia blu paralajmëroi pamundësimin e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit. Aksionin e opozitës, Basha e diskutoi edhe me kryebashkiakët e djathtë, të cilët i propozuan kryetarit demokrat që të dalë lista e kandidatëve për kryetarë bashkie, në mënyrë që ditën kur të plotësohen kushtet për t'u futur në zgjedhje, elektorati të jetë i njohur me figurat që propozon Partia Demokratike për drejtimin e 61 bashkive të vendit.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

VIZITA

PD-ja po punon edhe për një platformë të plotë qeverisëse. Më 26 prill pritet që një delegacion i CDU-së gjermane të mbërrijë në Tiranë, nga ku bashkë me kreun e Partisë Demokratike, Lulzim Bashën, do të prezantojnë për publikun platformën e opozitës.

PROGRAMI


Partia Demokratike, edhe pse ka shpallur mospjesëmarrjen në zgjedhjet vendore dhe është në rrugë për largimin e Ramës, paralelisht po punon për një platformë të plotë qeverisëse. Ekspertët po punojnë për një program 100 ditor, nesër në qeveri, ndërsa po asistohen nga ekspertët të CDU-së gjermane, të cilët do zhvillojnë në 26 prill në Tiranë. Krahas aksionit të protestave, kreu i opozitës Lulzim Basha, ka aktivizuar edhe grupet e punës brenda selisë blu, të cilat po hartojnë një program elektorale fokusuar në 100 ditët e para të Partisë Demokratike në qeveri, në qoftë se arrihet objektivi për largimin e Ramës dhe qytetarët do t'i besojnë pushtetin. Programi shtrihet në disa fusha kryesore, ekonomia, rendi, siguria, shëndetësia dhe arsimit, ndërsa ekspertët demokratë po asistohen nga ekspertët gjermanë të CDU-së. Për këtë qëllim, më 26 prill pritet që një delegacion i CDU-së gjermane të mbërrijë në Tiranë, nga ku bashkë me Lulzim Bashën do prezantojnë për publikun platformën e opozitës.

KËRKESA

Aksionin e opozitës, z.Basha e diskutoi edhe me kryebashkiakët e djathtë, të cilët i propozuan kryetarit demokrat që të dalë lista e kandidatëve për kryetarë bashkie, në mënyrë që ditën kur të plotësohen kushtet për t'u futur në zgjedhje, elektorati të jetë i njohur me figurat që propozon PD për drejtimin e 61 bashkive të vendit.

GRUPET E PUNËS

Krahas aksionit të protestave, z.Basha ka aktivizuar edhe grupet e punës brenda selisë blu, të cilat po hartojnë një program elektorale fokusuar në 100 ditët e para të Partisë Demokratike në qeveri, në qoftë se arrihet objektivi për largimin e Ramës dhe qytetarët do t'i besojnë pushtetin.



"Rreziku holandez për Shqipërinë"

Ironia e Berishës: Rama frymëzohet nga libri i Enver Hoxhës

Ish-kryeministri Sali Berisha u ndal sërish dje të votimit në Kuvendin e Holandës për rikthimin e vizave në vendin tonë. Këtë herë, Berisha ka zgjedhur të ironizojë pasardhësin e tij kryeministrin Edi Rama, të cilin e bën edhe autor të një libri lidhur me rastin, duke e paralelizuar me Enver Hoxhën. "Rreziku holandez për Shqipërinë" është titulli i librit i zgjedhur nga ish-kryeministri për të thumbar Ramën. Në kopertinën e librit, ish-kryeministri shton se ky libër është bazuar në veprën e ish-diktatorit famëkeq, Enver Hoxha. "Bazuar në veprën e shokut Enver Hoxha "Rreziku Anglo-Amerikan për Shqipërinë", shkruhet në kopertinë. Po dje ish-kryeministri, Sali Berisha, denoncoi heqjen e kalldrimit në pazarin e Gjirokastrës. Duke e cilësuar një krim atë që po ndodh, Berisha përmes një postimi në "Facebook", thotë se kalldrimet historike të qytetit të gurtë po shkatërrohen për të mbushur xhepat narko pushtetarët.

Protesta, Mediu: Duhet një organizim më i gjerë jashtë Tiranë

Kreu i PR-së Fatmir Mediu apelon për përshkallëzim të aksionit të opozitës, duke kërkuar që të ketë një përshkallëzim të mëtejshëm të protestave. Sipas Mediu deri më tani protestat e opozitës kanë qenë të përmbajtura, por në mendimin e tij Edi Rama mund të rrezohet vetëm duke e shtrirë protestën e opozitës në të gjithë vendin. Kemi pasur organizime politike kundër qeverisë, por protesta duhet sjellë deri në një përplasje më të madhe. Deri tani kemi qenë në një përplasje brenda Tiranës. Por duhet një organizim më i gjerë jashtë Tiranë. Qytetarët duhet ta marrin në dorë fatin e tyre. Ajo që dua të them është se Edi Rama shkatërroi gjithçka me vetëdije. Parlamenti u kthye në një haltore të Edi Ramës që përbuz dhe shan këdo. Edi Rama po kërkon që e keqja të bëhet e pranueshme. Ajo që do të ishte gabim nga opozita është ajo që ka të bëjë me një njeri racional. E keqja është ngritur ne sistem nga ky kryeministër në mënyrë të vetëdijshme. Ne duhet të mendojmë çdo skenar të zi nga Edi Rama", deklaroi z.Mediu.



Komisioni Qendror i Zgjedhje ka pezulluar tre tenderë me vlerë rreth 1 miliard lekë dhe që kanë të bëjnë me blerjen e bazës materiale dhe fletëve të votimit. Në një prej tyre mësohet se është paraqitur ankesë për një kompani pjesëmarrëse në garë, çka në bazë të rregullave të tenderim-



Tenderi i fletëve të votimit, KQZ pezullon procedurën e prokurimit

it dhe prokurimit, KQZ është e detyruar të stopojë procedurën. Tashmë prodhimi i fletëve të votimit dhe i tabelave të rezultateve janë në një fazë negociimi me firmat garuese për të

gjetur ofertën më të mirë. Por burime nga KQZ kanë bërë të ditur se në këtë çështje nuk ka vend për panik, pasi bëhet fjalë për një procedurë standarde që parashikon ligji. Ndaj sipas

të njëjtave burime mësohet se procedura e tenderimit mbyllet këtë javë dhe më pas firma fituese do vijojë me sigurimin e fletëve të votimit dhe tabelave të rezultateve.

Ish-ministri shprehet kritik ndaj qëndrimeve, që e etiketojnë si raciste ndaj shqiptarëve

Bushati kundër Ramës: Nuk duhet ta neglizhojmë qëndrimin e Holandës

"Shanset që kjo nismë të prodhojë efekte janë thuajse zero"

Pak ditë më parë parlamenti i Holandës miratoi një rezolutë nëpërmjet së cilës i kërkon qeverisë nisjen e procedurave në nivel evropian për pezullimin e regjimit pa viza me Shqipërinë. Një vendim që në Shqipëri komentua në mënyrë të ndryshme nga klasa politike, ku opozita nxitoi të tregoi se kjo ishte pasojë e dështimit të luftës së qeverisë kundër kimit, ndërsa mazhoranca u përpoq ta cilësonte atë si një vendim politik dhe kundër shqiptarëve. "Është një vendim thjeshtë dhe vetëm politik në vazhdim të një procesi elektoral në një vend si Holanda, ku nuk është sekret, ka një zhvillim të vazhdueshëm të një politike intensivist kundër zgjerimit, intensivist kundër emigrantëve, intensivist kundër shqiptarëve. Shqiptarët janë zgjedhur nga disa parti në atë vend si një kokë turku për retorikën agresive izolacioniste", - u shpreh kryeministri Edi Rama të enjten e shkuar nga foltorja e Kuvendit. Por duket se një qëndrim i tillë nuk i është dukur i drejtë ish-ministrit të Jashtëm të larguar vetëm pak muaj më parë, Ditmir Bushati, i cili nëpërmjet një analize të publikuar në faqen e tij në 'Facebook', thekson se nuk ka vend për panik në këtë vendim marrje, por nga ana tjetër thekson se qëndrimi i Holandës nuk duhet neglizhuar. "Shanset që një nismë e tillë të prodhojë efekte në praktikë janë thuajse zero. Ndaj nuk ka vend për panik. Shqipëria edhe pse ka shumë sfida në betejën me krimin e organizuar dhe korrupsionin i përbush kriteret e përcaktuara sipas vlerësimeve të Komisionit Europian. Megjithatë, nuk ka vend për neglizhencë e aq më keq për stigmatizim. Përkundrazi duhet të sigurojmë integritetin e debatit publik në lidhje me këtë çështje", - shkruan Bushati në komentin e vet. Nga ana tjetër ai thekson se paravarsisht përbuzjes së çdo etiketit të pamerituar për



Ish-ministri Ditmir Bushati

shqiptarët, është e patolerueshme që nga ana e Shqipërisë të ketë kundërpërgjigje me të njëjtën gjuhë ndaj Holandës, duke e cilësuar raciste ndaj shqiptarëve. "Do të ishte gabim fatal që ta vizatonim Holandën, anëtare themeluese e kontribuese kyçe në BE, mbështetëse e aspiratës evropiane të Shqipërisë, si një vend racist ndaj nesh apo si një vend ku gëlon krimi e prostitucioni. Do të ishte mendjelehtësi, gjithashtu, të injoranim mesazhin që vjen prej kësaj nisme të parlamentit holandez, edhe pse i pari për një nga shtetet që janë pjesë e listës së bardhë të Schengen, nuk është rrufe në qiell të kaltër: Bushati bën të ditur se vjet, në vigjilje të vendimit të BE-

se për nisjen e bisedimeve për anëtarësimin, parlamenti holandez, përmes një rezolute, i kërkoj qeverisë bllokimin e bisedimeve me Shqipërinë. "Është fakt tani që i njohur se për shkak të kundërshtisë së Francës dhe Holandës, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk i nisën menjëherë bisedimet për anëtarësimin në BE. Kjo situatë shtyu vendet anëtare drejt një formule kompromisi me kalendrar të përcaktuar për nisjen e këtij procesi pas qershorit të 2019", - bën të ditur Bushati. Ndërkohë që kanë mbetur vetëm pak javë nga vendimarrja e vendeve anëtare të BE-së për zrytarizimin e bisedimeve për anëtarësimin, Bushati shprehet se historiku i mësipërm sjelljeve të Holandës duhet ta bëj Shqipërinë të demonstrojë kohezion politik e shoqëror dhe një fokus të ripërtëritë për reforma, duke mos lejuar në të njëjtën kohë cenimin e arritjeve historike.

HOLANDA

"Do të ishte gabim fatal që ta vizatonim Holandën, anëtare themeluese e kontribuese kyçe në BE, mbështetëse e aspiratës evropiane të Shqipërisë, si një vend racist ndaj nesh apo si një vend ku gëlon krimi e prostitucioni. Do të ishte mendjelehtësi, gjithashtu, të injoranim mesazhin që vjen prej kësaj nisme të parlamentit holandez, edhe pse e padrejtë dhe në mungesë të kriterëve të përcaktuara nga vetë BE-ja"

Sot afati i fundit, në zgjedhjet vendore regjistrohen 34 parti

Skadon sot në mbrëmje afati i fundit për regjistrimin e 30 partive politike që duan të garojnë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Përveç 25 partive që regjistruar deri më tani, pritet që gjatë ditës së sotme KQZ të miratojë edhe kërkesat për të marrë pjesë në zgjedhje edhe të 9 partive të tjera, ndërmyet të cilave një pjesë e tyre janë ose forca të djathta ose në opozitë me PS-në. Më konkretisht në mbledhjen e ditës së sotme pritet të regjistrohen: Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Demokratike Sociale e Paskal Milos, Partia Zgjidhja e Koço Kokëdhimës, Partia e Pajtitimit Kombëtar, Partia Social-Punëtorë, Partia Ligj dhe Drejtësi e Spartak Ngjelës, Partia Fryma e Re Demokratike e Bamir Topit, Partia Aleanca Kuq e Zi e Kreshnik Spahiu si dhe Partia Lista e Barabartë e krijuar nga Ben Blushi. Pra, bashkë me këto forca politike që do regjistrohen sot numri i përgjithshëm i partive që kanë shprehur interes për të marrë pjesë në zgjedhjet e 30 qershorit shkon në 34. Ky numër mund të rritet ende, pasi ende nuk ka një informacion të saktë nëse gjatë këtyre ditëve që kanë qenë ditë feste dhe pushimi apo edhe gjatë ditës së sotme, ka pasur parti të tjera që kanë shprehur interes për të marrë pjesë në zgjedhje. Një tjetër forcë që pritet të regjistrohet në zgjedhje është edhe G99 e Ervin Metës. Gjithashtu, gjatë ditës së sotme pritet që të paraqesë kërkesë pranë KQZ-së edhe Partia Bindja Demokratike, që po krijohet nga një grup demokratësh të kryesuar nga Astrit Patoci dhe Rudina Hajdari. Por paravarsisht se numri i partive pjesëmarrëse në zgjedhje është i konsiderueshëm dhe me pjesëmarrje edhe të forcave të djathta dhe opozitare, sërish mungesa e opozitës kryesore, asaj që përfaqësohet nga PD, LSI e partitë e tyre aleate, vë në pikëpyetje legjitimitetin e këtyre zgjedhjeve.

PARTITË E REGJISTRUARA

1. Partia Socialiste e Shqipërisë - Edi Rama
 2. Partia Socialdemokratike Shqiptare - Skënder Gjinushi
 3. Partia e Gjalbër - Edi Paliano
 4. Partia Kristian Demokratike - Dhimitër Musliu
 5. Partia Aleanca Demokratiane - Zef Bushati
 6. Partia Socialiste e Modernuar - Gjergji Kjoja
 7. Partia Unitet Kombëtar - Idajet Beqiri
 8. Partia Emigracionit Shqiptar - Kostaq Papa
 9. Partia e Përsosnave me Aftësi të Kufizuara - Gjovallin Shqalshi
 10. Partia Lëvizja Punëtorë Shqiptare - Genci Sakaj
 11. Partia e Drejtave të Moshara - Ili Vata
 12. Partia Demokratike e Re Europiane - Koci Tahiri
 13. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane - Valentino Mustaka
 14. Partia Demokratike dhe Solidaritet - Gago Apostolo
 15. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve - Ymer Kurti
 16. Minionetë Etnikë Grek për të Ardhmen - Kristo Kico
 17. Partia për Demokraci dhe Solidaritet - Gago Apostolo
 18. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve - Ymer Kurti
 19. Partia Komuniste e Shqipërisë - Cemal Ciccolari
 20. Partia Bashkimi Demokratik Shqiptar - Ylber Valtari
 21. Partia Ora e Shqipërisë - Zef Shkëmbi
 22. Partia Bashkimi Liberal Demokratik - Arjan Starova
 23. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë - Arjan Galidini
 24. Partia Kombëtare Konservatore - Kujtim Gluzi
 25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve - Kadri Isufaj
- PARTITË E TË JERË QË PRITET TË REGJISTROHEN**
26. Fryma e Re Demokratike - Bamir Topi
 27. Lista e Barabartë
 28. Partia Zgjidhja - Koço Kokëdhima
 29. Partia Demokratike Sociale - Paskal Milo
 30. Partia Ligj dhe Drejtësi - Spartak Ngjela
 31. Partia Socialpunëtorë Shqiptarë - Ramadan Ndreka
 32. Partia e Reformave Demokratike - Krenar Rryci
 33. Pajtimi Kombëtar Shqiptar - Spartak Dobi
 34. Aleanca Kuq e Zi - Kreshnik Spahiu
- PARTITË E TË JERË QË PRITET TË REGJISTROHEN**
35. Bindja Demokratike - Astrit Patoci
 36. G99 - Ervin Metë

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
 Rr: "Fishe Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, K1, 1, Tirane
 Web: www.3h-ai, Email: shqg_3h@yahoo.com, cel:069209711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.16.04.2019 deri ne dt. 24.04.2019 per: sendin e luajshem- automjetin terheqes Renault me Targa AA 245 OE, model Magnum 480 me cmim fillestar 751,800.00 Leke automjetin gjysem rrimorqj marka Fruehauf TD 35, me Targa AER 831 me cmim fillestar 98,800.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L.
Ankandi zhvillohet ne zyrën përmbarimore ne datën 24.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16:00

ATP/ Dokumentet që duhet të plotësojnë përfituesit për të marrë paratë

Tokat e zëna, 540 pronarë përfitojnë kompensimin

Lista e re/ Përfituesit në 7 qarqe të vendit

Rreth 540 pronarë që u është zënë toka nga ndërtime të paljeje do të përfitojnë kompensimin për pronën. Lista është publikuar nga Agjencia e Trajtimit të Pronave...

edokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues...

PRANIMI I KËRKESAVE Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik...

paraqitjes së kërkesës për kompensim e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së...

- 1. Kërkesa për kompensim sipas formatit-tip, e cila plotësohet në ATP.
2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues...
3. Prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim...
4. Vërtetim i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues...
5. Mandatpagesa që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.
6. Dokument identifikimi.

540 PRONARË PËRFITJONË KOMPENSIMIN

Table with 20 columns listing names and locations across various regions like Durrës, Shkollë, Kavajë, and others. Includes names like TRANE, OSMAN, DISHA, BESNIKU(KOPI)LI, etc.

Aksioni në terren i Task-Forcës, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Policisë së Shtetit

Task-Forca gjen në shkelje 160 subjekte

Kontrolle për transportin publik ndërqytetas dhe ndërkombëtar

Rreth 160 subjekte janë konstatuar në shkelje nga kontrollet e Task-Forcës së Transportit Rrugor. Ndryshim destinacioni, mungesë akti vlerësimi komoditeti si dhe mungesë dokumentacioni janë edhe shkeljet kryesore të evidentuara. Task-Forca e Transportit Rrugor, tashmë prej disa ditësh ka intensifikuar kontrollet në disa akse rrugore të vendit dhe ofton se do të vijojnë edhe në ditët në vijim, me qëllim rregullimin e konkurrencës së pandershme.

INSPEKTIMI

Intensifikohen kontrollet në linjat e transportit të udhëtarëve, Task-Forca e Transportit Rrugor ndëshkon 160 subjekte në kundërvajtje me ligjin. Task-Forca e Transportit Rrugor ka intensifikuar punën, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në mjetet e transportit të udhëtarëve, goditjen e paligjshmërisë dhe eliminimin e konkurrencës së pandershme, në respektim të drejtave ndaj operatorëve të ligjshëm që punojnë me këto linja. Aksioni në terren i Task-Forcës, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Policisë së Sh-



Foto ilustruese

tetit ka pasur në fokus konstatimin e pikave problematike, sipas denoncimeve nga vetë grupet e interesit, si dhe për të krijuar një panoramë sa më të qartë sa i takon situatës në të gjithë vendin. Që prej fillimit të muajit prill, Task-Forca e Transportit Rrugor ka ndërmarrë disa operacione blic, të cilat janë shtrirë në akset kryesore kombëtare dhe në terminalet me fluksin më të

lartë të trafikut. Subjekt i këtyre kontrolleve kanë qenë operatorët e linjave të transportit të udhëtarëve, si rrethqytetas, ndërqytetas dhe ndërkombëtar.

KONTROLLET

Nga kontrollet e ndërmarrë deri më tani, rreth 160 subjekte janë konstatuar me shkelje të rënda kryesisht, "ndryshim destinacioni", pa "akt vlerësimi komoditeti" dhe në shumë raste me mungesë doku-

mentacioni. Për të gjitha këto subjekte janë marrë masa përkatëse administrative. Kontrollet nga ana e Task-Forcës së Transportit Rrugor do të vijojnë edhe përgjatë ditëve në vijim, si rregullator i konkurrencës së pandershme, për rritjen standardeve të shërbimit dhe komoditetit të qytetarëve. Ky aksion ka ardhur pas udhëzimit të ministres së Infrastrukturasë dhe Energjisë, Belinda Balluku, e cila pak javë më parë thirrri në një takim përfaqësuesit e transportit publik ndërqytetas dhe ndërkombëtar që operojnë në vendin tonë. Në këtë takim ministrja u njoh me shqetësimet e tyre dhe i siguroi se të gjitha problematikat e ngritura do të marrin zgjidhje. Ministria garantoj se do të ketë një rregullim të operimit të linjave të transportit publik, duke theksuar se në fokus të kësaj ndërhyrjeje është goditja e paligjshmërisë në sektor, eliminimi i konkurrencës së pandershme dhe ofrimi i një shërbimi cilësor për qytetarët.

Raporti i Bankës së Shqipërisë:

U tkurr kredia për shtëpi

Bankat raportuan se kërkesa e individëve për kredi banesë ka rënë gjatë tremujorit të parë 2019, pas një rritjeje sistematike përgjatë dekadës. Sipas perceptimit të bankave të azhuruara në raportin për Vrojtimin e Aktivitetit Kredites, rënia e kërkesës për kredi në tremujorin e parë nga ana e individëve u shkaktua nga përdorimi më i lartë i burimeve të brendshme të financimit, kreditë nga bankat dhe institucionet financiare jobanka, besimi konsumator si edhe zhvillimet aktuale dhe të pritura në tregun e banesave. Ulja e kërkesës për kredi për shtëpi sipas Bankës së Shqipërisë po lidhet me zhvillimet në tregun e banesave. Volumet e ndërtimit janë rritur ndjeshëm edhe çmimet janë rritur gjithashtu. Sipas një vëzhgimi të revistës "Monitor" në kompanitë më të mëdha të ndërtimit në kryeqytet çmimet kanë luhatur të madhe, nga 500-600 euro në periferi në mbi 3000 euro për metër katror në zonat e qendrës. Çmimet janë rritur shpejt vitin e fundit, me 10-30% pas një stacioni që pëson në periudhën e mëparshme, të nxitura si nga rritja e taksave (kryesisht ajo e ndikimit në infrastrukturë), dhe nga oferta e shtuar, teksa sipas operatorëve janë rritur blerjet e apartamenteve në 'cash'. Ekspertët i tremben këtij fluksi ndërtimesh, përballë një fuqie të dobët blerëse, çka sipas tyre mund të rrezikojë një fluskë në të ardhmen.

BERZH, 1.1 miliardë euro në Ballkan në 2019-ën

Investimet do të realizohen përmes 67 projekteve

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim do të investojë përsëri rreth 1.1 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor këtë vit, me fokus në sektorin privat, lidhjen dhe tranzicionin në ekonominë e gjelbër, sipas presidentit të BERZH, Suma Chakrabarti. "Ne jemi një partner i vjetër i rajonit, i përkushtuar për të mbështetur ndërtimin e një ekonomie që u lejon njerëzve të saj, sidomos të rinjve të vendosin talentet e tyre dhe të përfitojnë nga përpjekjet në vendin e tyre. Financimi i nevojave të vendeve duhet të jetë një rritje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për t'i shërbyer popullit të tyre", tha Chakrabarti për "See Nees" në një intervistë. Në Kosovë, BERZH po synon një rritje të ndjeshme të investimeve të saj deri në 100 milionë euro në vit gjatë periudhës së ardhshme, nga 52 milionë euro në vitin 2018. "Në total, ne kemi investuar 363 milionë euro në 63 projekte në Kosovë deri më sot. Sfidat që duam të trajtojmë janë të ngjashme me ato të rajonit më të gjërë: nxisnin potencialin e sektorit privat, forcojnë integrimin dhe adresojnë sfidën



e energjisë", tha Chakrabarti. Në vitin 2018, huadhëni ndërkombëtar investoi në shumë se 1.1 miliardë euro në Ballkanin Perëndimor përmes 67 projekteve. "Prioritetet tona janë zhvillimi i sektorit privat si motori i rritjes, punësimi dhe inovacioni; lidhja si një koncept që mbështet integrimin e rajonit jo vetëm në kuptimin fizik (infrastrukturë), por edhe përmes ndihmës për tregti dhe investime rajonale dhe krijojnë kushtet për përfundimin e BE-së dhe kalimin në një ekonomi të gjelbër, duke

adresuar sfidat urgjente mjedisore dhe gjithashtu duke rritur mbështetjen e vendeve në burimet e ripërtëritshme të energjisë", - shpjegoi Chakrabarti. Për energjinë e rinovueshme, ai shtoi: "Ne jemi duke punuar ngushtë me autoritetet për të finalizuar kuadrin rregullator në një formë që do të mundësojë investime në energji të pastër". Presidenti i BERZH tha gjithashtu se është i bindur se takimi i vjetor i bankës në Sarajevë, në maj do të ndihmojë në nxitjen e investimeve në të gjithë rajonin.



Implemented by giz

ProSEED: Announcement

Social Initiatives – Call for Expressions of Interest and submission of Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Social Initiatives seeks in partnership with local CSOs to foster the inclusion perspectives of marginalized youth in employment and/or education. In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) submission of project Proposals from **19 April – 10 May 2019** at giz-albanien@giz.de. The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging up to 50,000 EURO (equivalent in ALL).

Main Steps of the Procedure:

First step: (i) Expressions of Interest

All interested CSO at least with 2 years of experience implementing projects in the field of youth empowerment shall write to giz-albanien@giz.de with the following text:

"We herewith declare our interest to participate in the 3rd Call for Proposals, organized by the GIZ ProSEED programme under the Social Initiatives Component. Please send us the respective Application Package".

Second Step: (ii) Submission of Application.

Upon receipt of the application package the CSO should consult the Application Guidelines to prepare their project proposals for all related eligibility criteria. The Application Guidelines (a separate document) can be downloaded from the ProSEED Facebook page. Deadline for the submission of application is **10 of May 2019**.

The application package must be submitted electronically in English at giz-albanien@giz.de. Applications submitted in hardcopies shall not be taken into consideration. (Applying CSOs must take care to submit the budget in excel as a separate template and not merge it with the project description).

Third Step: (iii) Assessment and Evaluation of Proposals

Upon submission of the proposals by the CSOs the assessment and evaluation procedure shall be implemented as described in the Application Guidelines. For more information and the timeline of procedure please consult the Application Guidelines of this 3rd Call for Proposals.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to express your interest and receive the application package.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **19 April – 10 May 2019**.

Spitali: 25-vjeçarja Rexhina Debrova pësoi komplikacion

Nëna humb jetën një orë pas lindjes, familjarët akuzojnë mjekët

ARRESTOHEN 2 MJEKE

Policia e Elbasanit ka arrestuar dy mjekë pas vdekjes së 25-vjeçares Rexhina Debrova pak minuta pas lindjes. Sipas informacioneve të para, janë arrestuar mjeku reanimator Nikollaq Thanosi dhe mjeku kardiolog Mehmet Ibaq.

sepse ka konstatuar probleme me zemrën. Familjarët pretendojnë se mjeku kardiolog ka mbërritur me vonesë, ndërsa nëna e re ndërroi jetën një orë pas lindjes. Sakaq do të jetë autopsia dhe hetimet

do të përcaktojnë shkaku të vdekjes së 25-vjeçares nëse ka pasur apo jo neglizhencë nga ana e bluzave të bardha. Pas vdekjes së 25-vjeçares 1 orë pas lindjes ka reaguari Qendra spitalore e Elbasanit.

it. Në një deklaratë për mediat, spitali thotë se e reja pësoi komplikacion, ndërsa mjekët dhanë shërbimin maksimal. Megjithatë priten ekspertiza mjeko-ligjore për përcaktimin e shkaktit të vdekjes së 25-vjeçares në Elbasan. Por spitali nuk tregon orën e vdekjes së gruas së re. "Duke shprehur ngushëllimet familjarëve për humbjen e 25-vjeçares R. D., Spitali rajonal Elbasan shton opinionin publik në lidhje me humbjen e jetës së 25-vjeçares" si



vijon: Pacientja R. D. u paraqit në spital më datë 22.04.2019 në orën 10:25 para-dite. Pacientja ka ardhur me urgjencë në spital, me barrë të vonuar 42-javëshe dhe është futur në sallë, ku mjekët asistuan lindjen e fëmijës, i cili erdhi në jetë në orën 11:50. Foshnja u reanimua dhe gëzoi shëndet të

mirë. Stafi mjekësor ka dhënë trajtimin e duhur mjekësor, por nëna e re dyshohet se pësoi komplikacion postoperator trombemboli pulmonar, e papajtueshme me jetën. Aktualisht priten rezultatet e ekspertizës mjeko-ligjore për shkaku të vdekjes së nënës", deklaroi spitali.

Zyrtari holandez: Nuk mbajnë varëse ari, s'dinë atraksione turistike

Nga Martin Kuiper

Një shqiptar i arrestuar në Holandë për trafik droge jep përherë të njëjtin justifikim, thotë prokurori Otto van der Bijl. Ai thotë se po viziton Amsterdamin si turist. Por nëse e pyesni se çfarë do të bëjë në qytet, thotë oficeri, ai nuk mund të emërojë ndonjë atraksion turistik. Ai, gjithashtu, nuk mban mend emrin e hotelit të tij. Dhe përse ka mijëra euro me vete kur paga mesatare mujore në Shqipëri është rreth 330 euro. Të enjten e kaluar, shumica e Dhomës së Përfaqësuesve (VVD, PVV, CDA, PS dhe CU) votuan në favor të rifutjes së kërkesës për viza për shqiptarët. Ata tani mund të udhëtojnë nëpër Evropë për tre muaj pa vizë. Kriminelët e përdorin këtë periudhë për të zgjeruar rrjetet e tyre të kontrabandës, sipas deputetes Madeleine van Toorenburg (CDA). Shenjat e para erdhën para tre apo katër vjetësh, thotë prokurori publik Van der Bijl. Shqiptarët po arrestohen gjithnjë e më shumë në Amsterdam dhe Rotterdam. Fillimisht, thotë Van der Bijl, mendohej për rastet klasike: trafik droge, pastrim parash, armëmbajtje pa leje. Por në të njëjtën kohë, po vinin kërkesat për ndihmë juridike nga Italia, Belgjika, Gjermania, Franca, Anglia dhe Suedia. Ata kërkonin ndihmën holandeze në sigurimin e provave kundër shqiptarëve të arrestuar. Hetimet policore, gjithashtu, treguan se shqiptarët e kanë ndërtuar shejt perandorinë e tyre të drogës. Sipas Otto van der Bijl, shqiptarët janë një nga bandat më të rëndësishme të drogës në Holandë. Shqiptarët menaxhojnë linjat e drogës nga Amerika e Jugut, duke përfshirë Kolumbinë, Holandën dhe Belgjikën. Ata shesin kryesisht kokainë. Ajo arrin nëpërmjet porteve të Rotterdamit dhe Antwerpes dhe



më pas dërgohet në Amsterdam, ku është qendra e shpërndarjes, sipas oficerit. Ajo fshihet në makina dhe kamionë e më pas dërgohet në vende të tjera, thotë Van der Bijl. Gjatë tre viteve të fundit, në Holandë janë arrestuar rreth 1700 të dyshuar shqiptarë, sipas shifrave të fundit të policisë, duke cituar ministrin e Drejtësisë, Ferdinand Grapperhaus (CDA) dhe kolegjin e tij Stef Blok, ministrin e Punëve të Jashtme (VVD). Të dyshuarit janë të lidhur me krimin e rëndë të organizuar: Numri i arrestimeve ishte shumë më i ulët në vitet e kaluara. Vlerësimi Kombëtar i Kërcënimeve të vitit 2017, një përmbledhje katërvjeçare e krim të organizuar, thotë: "Roli i shqiptarëve në lidhje me trafikimin e drogës është i ri". Holanda ka punuar me Shqipërinë që nga maji i

vitit të kaluar për të luftuar aktivitetet kriminale. Dhjetë vjet më parë, shqiptarët ende punonin si "ushtarë" për mafien italiane, thotë Van der Bijl. Ata bënë punë të ndryshme për ta. Në emër të mafies, ata peshkuan partnerët në portet evropiane. Shqiptarët tani punojnë në mënyrë të pavarur, sipas oficerit. Shqiptarët njihen si tregtarët shumë të mirë, thotë një agjent i cili ishte i përfshirë ngushtë në hetimet ndaj kriminelëve shqiptarë në Holandë dhe që për arsye sigurie nuk do ta vendosë emrin e tij në gazetë. Ata ofrojnë kokainë të mirë me çmim të ulët dhe janë jashtëzakonisht të besueshëm. Kokaina është menduar kryesisht për tregun ndërkombëtar, thotë Van der Bijl. Detektivi e pranon këtë: "Nëntoka e Amsterdamit ka të bëjë me tregun lokal të drogës, kurse sh-

qiptarët merren me tregun ndërkombëtar". Për shkak të ndarjes së tregjeve, përplasjet mes dy grupeve janë të rralla, sipas detektivit dhe oficerit. Shqiptarët po luftojnë kundër përplasjeve të ndërsjella në vendin e tyre, sipas detektivit. Ata kanë një reputacion jashtëzakonisht të dhunshëm, por e mbajnë dhunën jashtë skemës, pasi nuk duan të tërheqin vëmendjen. Dy vjet më parë, policia dhe gjyqësori analizuuan pesëdhjetë faqet e internetit më të vizituara në Shqipëri dhe përdorimin e tyre në Holandë, thotë Van der Bijl. Për shembull, policia dhe gjyqësori u përpoqën të shikonin sa shqiptarë po qëndrojnë në Holandë. Me 36,000 smartphones dhe afro 4,500 tableta, një nga ato pesëdhjetë faqet e internetit nga Holanda u vizitua në korrik

SI I PASTROJNË PARATË
"Ata i sjellin fitimet në vende të fshehura në makina ose me biçikleta në çanta të mëdha tregtare. Pjesa më e madhe është dërguar në vendin e origjinës", - thotë Van der Bijl. Ndonjëherë ajo është investuar në Amsterdam, Rotterdam dhe industrinë e shërbimit në Hagë. Në Rotterdam, kriminelët investojnë paratë e tyre në bare dhe piceri.

çanta të mëdha tregtare. Pjesa më e madhe është dërguar në vendin e origjinës, thotë Van der Bijl. Ndonjëherë ajo është investuar në Amsterdam, Rotterdam dhe industrinë e shërbimit në Hagë. Në Rotterdam, kriminelët investojnë paratë e tyre në bare dhe piceri. "Ne kemi gjetur njëqind mijë euro kesh në shtëpinë e një pronari picerie." Shqiptarët përdorin, thotë oficeri, një mashtrim pasi ndryshojnë mbiemrin e tyre të fundit. Në Shqipëri, si në vendet e tjera të Evropës Lindore, është e mundur të ndryshoni mbiemrin tuaj disa herë. Kriminelët e bëjnë këtë të mos shfaqen në sistemin gjatë një kontrolli. Në rast të ndalimit, merren shenjat e gishtërinjve, por zyrtari mesatar doganor në kufi kërkon vetëm mbiemrin. Kjo duhet ndryshuar, thotë Van der Bijl. Një mënyrë tjetër për të shqetësuar kriminelët shqiptarë, thotë oficeri, është që të rifillojë kërkesat për viza. Kabineti qeveritar duket se nuk e mbështet këtë. Sipas ministrit Blok, shtetet e tjera anëtare evropiane nuk janë në favor të një kërkesë për vizë, sepse Shqipëria ende plotëson kushtet për anulimin e këtij detyrimi. Organizatat shqiptare janë tepër profesionale dhe kanë një kapacitet të madh rritjeje, thotë Van der Bijl. "Nëse fitojnë miliardë në një moment, krijohet një organizatë si mafia italiane, e cila, gjithashtu, përpiqet të ndikojë politikanët holandezë. Ne i druhami kësaj. NRC.nl

Drejtuesja e INAS Albania: Sa të ardhura duhet të kenë në bankë, kostot e tjera

Beskida Aliaj: Procedura që duhet ndjekur për të studiuar në shtetin italian

"Dokumentacioni i plotë që duhet të dorëzojnë kandidatët"

Voltiza Duro

Kandidatët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta për vitin e ri akademik 2019-2020 në universitetet italiane tashmë mund të njihen me procedurën që duhet të ndjekin për të aplikuar për vizë studentit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", drejtuesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj flet për kërkesën që duhet të plotësojnë studentët, afatet e aplikimit si dhe dokumentacionin e plotë që duhet dorëzuar për t'u pranuar. Të interesuarit duhet të kenë parasysh që iu nevojitet një llogari rrjedhëse personale e hapur në një nga institucionet bankare italiane të pranishme në Shqipëri që vërteton zotërimin e kriterit minimal të burimeve financiare me një shumë prej 5.953,87 në vit, në emër të studentit. Gjithashtu, studentët duhet të dorëzojnë edhe dokumentet e vërtetimit të vendbanimit në Itali si dhe sigurimin shëndetësor.

Si mund të aplikojnë për vizë studentit të interesuarit që dëshirojnë të studiojnë në Itali gjatë vitit akademik 2019-2020?

Studentët me banim në juridiksionin e Kancelarisë Konsullore të Tiranës, të cilët kanë paraqitur kërkesë për pararegjistrim universitar pranë kësaj kancelarie konsullore, mund të bëjnë kërkesë për vizë studimi "regjistrim në universitet" duke marrë takim në Zyrën e Vizave, nëpërmjet shërbimit Prenota Online.

Kur është afati i fundit i aplikimit dhe kur do të mund të marrin vizën fituesit?

Për t'u mundësuar studentëve pjesëmarrjen në provimin e pranimit, duke përfshirë edhe provën e gjuhës italiane, kjo Zyrë Vizash do të lëshojë një vizë hyrëse brenda datës 23 gusht 2019. Ftohen studentët të paraqiten në kohë, mundësisht brenda datës 19 gusht 2019.

Si vijon procedura pas hyrjes në shtetin italian?

Brenda 8 ditë pune nga hyrja në territorin italian, studentët, të cilët janë pajisur me vizë duhet të paraqesin kërkesën pranë kuesturës përkatëse për pajisjen me lejen e qëndrimit.

Sa është pagesa për kërkesën e vizës së studimit?

Kërkesa për vizë studi-



Drejtuesja e patronatit INAS Albania, Beskida Aliaj

AFATI I APLIKIMIT

Për t'u mundësuar studentëve pjesëmarrjen në provimin e pranimit, duke përfshirë edhe provën e gjuhës italiane, kjo zyrë vizash do të lëshojë një vizë hyrëse brenda datës 23 gusht 2019. Ftohen studentët të paraqiten në kohë, mundësisht brenda datës 19 gusht 2019.

mi për regjistrim universitar kërkon një pagesë prej 50, e cila nuk kthehet mbrapsht. Pas verifikimit të kërkesave sipas ligjit, ambasada italiane do të lëshojë vizat hyrëse për studim/universitet. Mbetet e vlefshme kompetenca e autoritetit konsullor për mosdhënien e vizës për vlerësim të rrezikut të emigrimit.

Lëshimi i vizës nuk nënkupton njohjen e titujve apo regjistrimin, të cilat mbeten kompetencë ekskluzive e universiteteve.

Cili është dokumentacioni që duhet të dorëzojnë studentët?

Studenti duhet të dorëzojë këto dokumente: formulari i kërkesës për vizë; pasaporta me vlefshmëri mbi tre muaj nga data e skadencës së vizës; fotoko-

pje të faqes së pasaportës me të dhënat personale; 2 fotografi të kohëve të fundit format dokumenti; certifikatë lindjeje në origjinal në formatin me shumë gjuhë e apostiluar, nëse nuk e kenë dorëzuar në fazën e para-regjistrimit; deklaratë vlefshmërie e titullit të studimit shqiptar, që mundëson regjistrimin në universitetet italiane (nëse nuk është kryer në fazën e para-regjistrimit).

A nevojiten dokumentet që vërtetojnë vendbanimin në Itali?

Po duhet edhe dokumentacioni që vërteton vendbanimin në Itali. Nëse do të jetoni pranë personave privatë duhet një deklaratë mikpritjeje dhe bashkangjitur fotokopje e një dokumenti identiteti të firmosur nga pritësi (nëse është shtetas i huaj); fotoko-

pje e lejes së qëndrimit të vlefshme për periudhën që ju fton dhe kartës së identitetit; nëse është shtetas Italian duhet fotokopje të pasaportës ose e kartës së identitetit). Ndërsa nëse do të jetoni pranë enteve, institucioneve, kongregacioneve fetare duhet të dorëzoni një deklaratë mikpritjeje nga enti, bashkë me një fotokopje të një dokumenti identiteti të firmosur nga ftuesi; kopje e kontratës së qerasë të firmosur, e nëse do të jetoni në hotele, pensione nevojitet një vërtetim prenotimi për një muaj.

Sa duhet të jenë të ardhurat minimale të deklaruar nga studentit për të vijuar studimet në shtetin Italian?

Duhet bërë deklarimi i të ardhurave financiare për jetesën. Duhet një llogari rrjedhëse personale me urdhër të parevokueshëm transferte, të hapur në një nga institucionet bankare italiane të pranishme në Shqipëri që vërteton zotërimin e kriterit minimal të burimeve financiare të përcaktuara nga MIUR me një shumë prej 5.953,87 në vit, në emër të studentit. Për të vërtetuar këtë kërkesë nuk mund të përdoren para në dorë, garanci ekonomike të dhëna nga persona jashtë familjes, fidejucione bankare apo police fidejucionare. Kërkohe, gjithashtu, paraqitja e dokumentacionit të apostiluar dhe të përkthyer në

PAGESA E VIZES

Kërkesa për vizë studimi për regjistrim universitar kërkon një pagesë prej €50, e cila nuk kthehet mbrapsht. Pas verifikimit të kërkesave sipas ligjit, ambasada italiane do të lëshojë vizat hyrëse për studim/universitet. Mbetet e vlefshme kompetenca e autoritetit konsullor për mosdhënien e vizës për vlerësim të rrezikut të emigrimit.

një police sigurimi të cilin mund ta nënshkruajë me mbërritjen e tij në Itali dhe e cila mbulon në rastet e kurave mjekësore, shtrimit spitalor.

Po nëse studentit është ende në moshë të mitur, si veprohet?

Në këto raste duhet kujdestari e plotë për studentin në moshë të mitur. Studentët e mitur në momentin e prezantimit të kërkesës së vizës duhet të paraqiten në sportel të shoqëruar nga të dy prindërit duke paraqitur: certifikatë familjare të apostiluar; akt dakordësie mbi largimin jashtë shtetit të të miturit, të firmosur para noterit nga të dy prindërit mbi bazën ligjore shqiptare, të apostiluar dhe të përkthyer në italisht; garanci të dokumentuar mbi kujdestarinë dhe mbrojtjen e vazhdueshme të minoritetit gjatë qëndrimit, e vërtetuar për shembull në format e mëposhtme: a) sistemim në konvikt dhe deklaratë e marrjes së përgjegjësisë mbi minoritetin nga ana e rektorit të kolegjit bashkë me një fotokopje të dokumentit të këtij të fundit; b) vendim të gjykatës italiane përkatëse për të miturit mbi kujdestarinë në emër të një të besuari të prindërve, me qëndrim të rregullt në Itali, që mban përgjegjësi derisa minoriteti të mbushë moshën 18 vjeç.

Cila është ndihma që i ofrohet aplikantëve nga Patronati INAS Albania?

Patronati INAS ALBANIA, jep të gjithë konsulentën e nevojshme, që nga fillimi i procedurave dhe deri në mbylljen e tyre për të gjithë studentët që paraqiten pranë zyrave tona. Edhe mbas fitimit të së drejtës për studime në Itali, INAS ALBANIA, ndihmon studentët shqiptarë, nëpërmjet strukturave që ka në të gjithë Italinë, deri në akomodimin e plotë të tyre si edhe në plotësimin e dokumenteve për leje qëndrimi italian nga zyrat e Patronato Inas Cisl që ndodhen të shpërndara në të gjithë Italinë. Numri i telefonit është 0683448188, ndërsa adresa në rrugën Andon Zako Cajupi, Pll.7, mbrapa shkollës Edith Durham, ish-Blloku, Tiranë.

MATURA SHTETËRORE FORMULARËT

Voltiza Duro

Maturantët që nuk kanë aplikuar me formularin A1/A1Z do të kenë mundësinë të plotësojnë formularin online në datat 27-31 maj të këtij viti. Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton kështu rihapjen e portali të Maturës Shtetërore online. "Njoftohen të gjithë maturantët/ kandidatët që nuk kanë aplikuar me formularin A1/A1Z në portalin Matura Shtetërore 2019, se portali i Maturës Shtetërore online dhe Portali e-Albania do të hapen për aplikime nga data 27 maj deri më 31 maj 2019, nga ora 09.00 deri në orën 16.00. Plotësimi online i formularit A1/A1Z, bëhet në shkollat ku maturantët/kandidatët kanë kryer arsimin e mesëm të lartë ose në shkollën e përcaktuar nga KMSH-ja e vendbanimit, nëse shkola e mesme që kanë përfunduar është mbyllur", bën me dije QSHA. Më tej kjo e fundit thekson se procesi i plotësimit të Formularit A1/A1Z ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet "mbikëqyrës". Përfaqësuesit e shkollës do të marrin kontaktet e maturantit/kandidatit për ta njoftuar me vonë për paraqitjen në shkollë për hedhjen e të dhënave shkollore të tre viteve të arsimit të mesëm.

TESTIMI

Ndërkohë nga data 7 deri në 24 qershor të këtij viti, do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2019. Përkatesisht maturantët në 7 qershor do t'i nënshtrohen provimit të parë, atij të gjuhës së huaj; në 12 qershor do testojnë njohuritë në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, ndërsa provimi i Matematikës do të zhvillohet në 17 qershor të 2019-ës. Ndërkohë në udhëzimin bëhet me dije për të gjithë maturantët e vitit mësimor 2018-2019 se provimi me zgjedhje do të mbahet në 24 qershor.

"Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2019, bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, miratuar me urdhrin nr. 780, datë 23.11.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, të përcaktojnë testin për secilin provim të Maturës Shtetërore. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019 fillojnë në orën 10:00. Dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta. Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja", theksohet në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë. Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me

Udhëzimi i MASR: Si do të vlerësohet testi, procedura e ndjekur për mbetësit

QSHA: Mundësi e dytë për maturantët, datat kur do të rihapet portali

"Plotësim i formularit A1/A1Z nga ata që s'kanë aplikuar"



PROVIMET

Nga data 7 deri në 24 qershor të këtij viti do të zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore 2019. Përkatesisht maturantët në 7 qershor do t'i nënshtrohen provimit të parë, atij të gjuhës së huaj; në 12 qershor do testojnë njohuritë në lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, ndërsa provimi i Matematikës do të zhvillohet në 17 qershor të 2019-ës.

DATAT DHE TESTIMET

Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2019,

- a) Gjuhë e huaj: 7 qershor 2019;
- b) Gjuhë shqipe dhe letërsi: 12 qershor 2019;
- c) Matematikë: 17 qershor 2019;
- d) Provimi me zgjedhje: 24 qershor 2019.

Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2019:

- > Fillojnë në orën 10:00.
- > Provimet e detyruara dhe me zgjedhje zgjasin 2 orë e 30 minuta.
- > Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.
- > Testi për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje vlerësohet me 60 pikë maksimale.
- > Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, rijapin provimet në sesionin e dytë.

zgjedhje do të vlerësohet me 60 pikë maksimale. Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2019, do të rijapin provimet në sesionin e dytë. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, do të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018-2019, dhe brenda datës 5 qershor 2019, do t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik matura online. "Listat e maturantëve mbetës të der-

gohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik. Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2019, pa likuiduar më parë provimet e klasës. Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë", thuhet në Fletoren

Zyrtare.

**SEKSIONI
DYGJUHËSH**

Ndërkohë, testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiane) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane do të përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi do të zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse. Ndërsa testi i provimit "Gjuhë frënge" (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe

shqiptaro-franceze përgatitet nga ambasada franceze dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse. "Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore 2019 bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit paktohen për çdo qendër më vete.

Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2019 zhvillohen në qendrat e provimeve të përcaktuara nga Komisioni i Maturës Shtetërore në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2019, në Republikën e Shqipërisë", theksohet në udhëzim.

27

**MAJ
HAPJA E
PORTALIT**

Maturantët që nuk kanë aplikuar me formularin A1/A1Z do të kenë mundësinë të plotësojnë formularin 'online' në datat 27-31 maj të këtij viti. Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton kështu rihapjen e portali të Maturës Shtetërore 'online'.

24

MAJ 2019

Testi i provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiane) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet më datë 24 maj 2019, në shkollat përkatëse.

5

**QERSHOR
LISTA**

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollor 2018-2019 dhe brenda datës 5 qershor 2019 t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik matura 'online', sipas udhëzimit.

Kosova rikthehen 110 persona nga zonat e luftës

Disa gra kosovare të kthyer nga Siria po hetohen për pjesëmarrje në grupe terroriste

Policia dhe prokuroria e Kosovës kanë filluar intervistimin e disa grave që janë kthyer të shtunën në mëngjes nga Siria, me dyshimin se ishin pjesëmarrëse në grupe terroriste. Të shtunën në mëngjes autoritetet e Kosovës të ndihmuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kthyer 110 persona nga zonat e luftës në Siri, 74 fëmijë, 32 gra dhe 4 persona të rritur që dyshohet se kanë qenë luftëtarë.

KTHIMI NE KOSOVE

Të shtunën në mëngjes autoritetet e Kosovës të ndihmuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kthyer 110 persona nga zonat e luftës në Siri, 74 fëmijë, 32 gra dhe 4 persona të rritur që dyshohet se kanë qenë luftëtarë.

ndon në zonën e luftës në Siri. "Policia e Kosovës, më ka ftuar përmes Odës së Avokatëve sipas detyrës zyrtare të mbrojta një grua, e cila dyshohet se ka marrë pjesë në grupet terroriste në Siri. Zona që mbrojtja ishte mjaft e dobët, nënë e katër fëmijëve. Më tutje se di ç'do vendosë Prokuroria Speciale e Kosovës, duke qenë se është

një sfidë edhe për vetë institucionet e Kosovës, sepse tashmë këto jo vetëm që janë të dyshuara, por edhe në anën tjetër, janë nëna," tha avokatja Gashi-Bytyqi. Aktualisht, të gjithë të kthyerit po i nënshtrohen kontrolleve mjekësore dhe ende nuk dihet kur do të lirohen. Nga personat e kthyer janë edhe katër militantë, të cilët

aktualisht janë në paraburgim si të dyshuar për pjesëmarrje në organizata terroriste. Naile Arifi nga Prishtina, erdhi në qendër me familjen e saj për të vizituar gruan dhe pesë fëmijët e vëllait të saj, i cili ka vdekur në zonat e luftës në Siri para tri vite e gjysmë. Në një bisedë për Radion Evropa e Lirë, ajo tha se nuk i ka parë familjarët e saj për pesë vite e gjysmë. "Në këtu kemi ardhur të shohim fëmijët e vëllait dhe gruan e tij. I takuam, mirë qenkan, mirë i kanë pritur. I falënderoj edhe këta (institucionet) që i kanë pritur mirë. Që pesë



vjet e gjysmë nuk i kemi parë deri më tani. Gjendja e tyre është mirë, edhe pse një fëmijë i vëllait e kishte thyer këmbën, por mirë janë këta të tjerët," tha Arifi. Takimi i Nailes me pesë fëmijët dhe gruan e vëllait të saj zgjati rreth 10 minuta. Nailla është vetëm njëra nga shumë anëtarë familjarë që vijnë të vizitojnë të afërmit

e tyre që po qëndrojnë në këtë qendër. Vizitat e tyre zakonisht zgjasin vetëm disa minuta. Sipas Policisë së Kosovës, në Siri ende janë rreth 30 luftëtarë, 49 gra dhe tetë fëmijë të cilët janë me shtetësi kosovare. Që nga viti 2012 rreth 400 njerëz nga Kosova i janë bashkuar të ashtuquajturit Shteti Islamik.

Raundi i parë i votimit për president, pjesëmarrje e ulët e qytetarëve

Maqedoni e Veriut, Pendarovski e Siljanovska kalojnë në balotazh

Mori 10% të votave, kandidati shqiptar: Është ushtruar presion

Ditën e djeshme u mblyllën në orën 19:00 qendrat e votimit për zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut, ku u vërejt një pjesëmarrje e ulët nga ana e qytetarëve. Sipas konferencës së fundit për media të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), pjesëmarrja e votuesve deri në orën 18:30 ishte 37,71%. KSHZ theksoi se procesi zgjedhor është zhvilluar pa pengesa serioze dhe në mënyrë të rregullt. Ndërkaq kandidati socialdemokrat i partive të koalicionit, Stevo Pendarovski ka shënuar një epërsi të lehtë ndaj kandidatit të opozitës, Gordana Siljanovska - Davkova në raundin e parë të zgjedhjeve presidenciale që u zhvilluan. Sipas rezultateve preliminare nga rreth 100% të votave të numëruara, Pendarovski ka fituar 42,72% të votave, ndërsa Siljanovska - Davkova ka fituar 42,58% të votave, ndërsa kandidati i tretë Blerim Reka i mbështetur nga Aleanca për Shqiptarët dhe BESA ka fituar 10,35% të votave, raporton INA. Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska janë kandidatët që kanë kaluar në raundin e dytë në garën për president. Raundi i dytë do të mbahet me 5 maj, 2019. Ndërkaq kandidati për president i mbështetur nga opozita shqiptare, Blerim Reka, në një dalje për mediat u shpreh i bindur që udhëheq në të gjitha komunat ku banojnë shqiptarët. Sipas tij, partitë në pushtet kanë ushtruar një presion të madh kundrejt votuesve shqiptarë dhe se elektorati është i kapur. Gjithsesi ai theksoi se ishte optimist, sepse mbi 50 për qind të votave të numëruara deri më tani, ai ka marrë mbi 50 mijë vota dhe kjo do të thotë shumë. Reka më tej tha se ky korpus i votave "Reka për Republikën" paralajmëron një pranverë të re për vendin dhe



Kandidatja e opozitës, Gordana Siljanovska



Kandidati socialdemokrat i partive të koalicionit, Stevo Pendarovski

shumë shpejt do të kemi zgjedhje të reja parlamentare. Në fund ai u shpreh se nuk është dakord me këtë sistem zgjedhor për zgjedhjen e presidentit duke sugjeruar rritjen e kompetencave të presidentit të republikës. Nga ana tjetër, dje Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve tha se zgjedhjet kaluan në një atmosferë të qetë dhe demokratike, me shumë pak parregullsi, ndërsa jehona e votuesve ka qenë mbi 42%. Këto ishin zgjedhjet e gjashta presiden-

cialë nga pavarësimi i vendit nga ish-republika jugosllave në vitin 1991. Të drejtën e votës e kishin mbi 1.8 milionë qytetarë. Për shkak të rezultati të arritur, do të zhvillohet raundi i dytë më 5 maj. Edhe gara e 5 majit pritet të jetë e vështirë pasi sipas ligjit elektorat, pjesëmarrja në zgjedhje duhet të jetë mbi 50% që rezultati të konsiderohet i vlefshëm. Nëse nuk përmbushet kriteri i pjesëmarrjes atëherë, vendi duhet të shkojë në

PUBLIKOHEN FOTOT E KAMPIT KU JETONIN TERRORISTËT SHQIPTARË

Producenti i NBC News, Mahmud Shikhibra ka publikuar dje disa fotografi të kampit sirian ku mendohet të kenë jetuar edhe kosovarë. Të paktën 110 persona të afërm të xhahadistëve nga Kosova që luftuan në Siri, janë kthyer të premtën mbrëma në Prishtinë. Disa nga të kthyerit në Kosovë tashmë po qëndrojnë në Qendrën e Azil-Kërkuesve në Vranidollë, pak kilometra larg kryeqytetit. Të premtën të paktën 32 gra, 74 fëmijë të lindur nga njëri prind me shtetësi kosovare (9 prej tyre janë kthyer pa prindër) dhe 4 burra, që dyshohet se kanë luftuar për organizatën terroriste ISIS, janë kthyer në Kosovë.

zgjedhje të reja. Edhe në këtë rast, përveçse për përcaktimin e kandidatit fitues, shqiptarët do të jenë faktor vendimtar edhe në vlefshmërinë e presidencialëve.

REZULTATI FINAL

Sipas rezultateve preliminare nga rreth 100% të votave të numëruara, Pen-

darovski ka fituar 42,72% të votave, ndërsa Siljanovska - Davkova ka fituar 42,58% të votave, ndërsa kandidati i tretë Blerim Reka i mbështetur nga Aleanca për Shqiptarët dhe BESA ka fituar 10,35% të votave, raporton INA.

BLERIM REKA:

"Partitë në pushtet kanë ushtruar një presion të madh kundrejt votuesve shqiptarë dhe elektorati është i kapur. Gjithsesi jam optimist sepse mbi 50 për qind të votave të numëruara deri më tani, kam marrë mbi 50 mijë vota dhe kjo do të thotë shumë," tha Reka.

Miliarderi humb tre fëmijët e tij në shpërthimin që u bë në një nga hotelet

Tragjedia në Sri Lanka, shkon në 290 bilanci i viktimave

Papa Françesku dënon sulmet, lutet për viktimat

Tragjedia që tronditi gjithë botën në ditën e shenjtë të Pashkës thellohet akoma më tepër. Bilanci i viktimave të vrarëve në Sri Lanka ka shkuar në 290, pas shpërthimeve që goditën kisha e hotele luksoze nëpër vend të dielën. Rreth 500 është numri i të plagosurve, ndërsa në mesin e të vrarëve, 36 janë të huaj. Policia tha se 24 persona janë vënë në pranga, por nuk dihet ende se kush qëndron pak këtyre sulmeve, më të rëndat që Sri Lanka ka parë që prej fundit të luftës civile në 2009. Shpërthimi i parë ndodhi rreth orës 08:45 të së dielës. Ai u pasua nga 5 shpërthime të tjera në një hark fare të shkurtër kohor. Teksa policia ishte vënë në kërkim të autorëve, u raportuan edhe 2 shpërthime të tjera. Ende nuk ka asnjë informacion mbi 24 të arrestuarit. Autoritetet besojnë se disa prej shpërthimeve ishin kamikaze. Pjesa më e madhe e viktimave janë shtetas nga Sri Lanka, shumë prej të cilëve besimtarë që ndodheshin në kisha për shërbimin e Pashkëve. Ndërkaq nuk ka mbetur pa reaguar edhe kreu i Kishës Katolike, Papa Françesku, i cili dënoi ashpër sulmet seriale me bombë mëngjesin e të dielës gjatë festës së pashkëve në tre kisha dhe tre hotele në Sri Lankë. Papa Françesku gjatë lutjes tradicionale të Pashkëve në sheshin e Shën Pjetrit dënoi sulmet. "Dua t'i shpreh afërsi dhe dashuri komunitetit krishter, i cili ishte shënjestër e sulmeve në kohën e lutjes dhe të gjitha viktimat e shtunës së tmerrshme", tha Papa Françesku. Papa, gjithashtu, u lut për viktimat dhe u uroi shërim të shpejtë të plagosurve. Shënjestër e sulmeve me bomba ishin tri kisha në qytetet Kochchikade, Negombo dhe Batticaloa dhe tre hotele luksuze Kingsbury, Cinnamon Grand dhe Shangri La në kryeqytetin e Sri Lankës, Colombo. Sulmet ndodhën gjatë festës katolike të pashkëve ndërsa mediat lokale raportojnë se në mesin e të vrarëve ka edhe turistë. BBC raporton se në mesin e të vrarëve janë të paktën 36 të huaj. Zëdhënësi i ushtrisë së Sri Lankës tha se 8 shpërthime kanë ndodhur në Dematogod në periferi të Colombos. Gazeta "Daily Mirror" raportoi se vendim të presidentit të Sri Lankës është shpallur ora policore, e cila do të zgjasë nga ora 06:00 e mëngjesit të së hënës deri në ora 18:00. Autoritetet në Sri Lankë përkohësisht kanë mbyllur rrjetet sociale 'Facebook' dhe 'Instagram' si dhe rrjetet e tjera për të parandaluar përhapjen e lajmeve të rreme dhe panikut. Nga ana tjetër, në tragjedinë e Sri Lankës u përfshi edhe famil-



Pamje nga tragjedia e së dielës në Sri Lanka

BILANCI I TRAGJEDISË NË SRI LANKA
Numri i viktimave në Sri Lanka ka shkuar në 290, pas shpërthimeve që goditën kisha e hotele luksuze nëpër vend të dielën. Rreth 500 është numri i të plagosurve, ndërsa në mesin e të vrarëve, 36 janë të huaj. Policia tha se 24 persona janë vënë në pranga, por nuk dihet ende se kush qëndron pak këtyre sulmeve.

Mori 73% të votave, Volodimir Zelenski në krye të Ukrainës

Entuziazëm nga fitorja e thellë e Volodimir Zelenski në balotazhin e zgjedhjeve presidenciale të së dielës në Ukrainë. Komediani 41-vjeçar siguroi rreth 73% të votave, në një fushatë të përqendruar tek premtimi për të luftuar korrupsionin, që ka zënë rrënjë thellë vitet e fundit. Premtoi po ashtu se do të zgjidhë konfliktin me r e b e l e t e filorusë në lindje të vendit. "Ne do të ecim me parimet e bisedimeve të Minskut drejt vendosjes së një armëpushimi të përhershëm". Ndërsa Petro Poroshenko pranoi humbjen duke thënë se do të qëndrojë në politikë, pasi vendi do të ketë nevojë për të. "Me një president të ri pa eksperiencë, Ukraina mund të kthehet shumë shpejt në orbitën e ndikimit rus. Me këtë rrezikojmë të humbim arritjet e deritanishme". Fitorja e Zelenskit u përshëndet nga i dërguari special i Shteteve të Bashkuara për negociatat e paqes në Ukrainë, Kurt Volker. Mesazh përshëndetës i dërgoi presidentit të ri edhe Kancelarja gjermane Angela Merkel, e po ashtu edhe kreu i Komisionit Evropian Zhan Klod Juncker. Edhe zyrtarët ruse thanë se shpresojnë se do të vendosnin një marrëdhënie të re me Kievin. Në fillim të qershorit, ai pritet të marrë zyrtarisht postin që e ka provuar vetëm në rolet e tij në filmat humoristikë.



ja e bilionerit dhe zotëruarit të ASOS, Anders Holch Povlsen. Ai ka humbur tre nga katër fëmijët e tij në sulmin e Sri Lankës gjatë pashkëve të dielën. Cifti u takua kur Ana, bashkëshortja, filloi të

punonte në sektorin e shitjeve në Bestseller. Ai është një nga njerëzit më të pasur të Danimarkës. Pas vdekjes së babait atij i kaloi biznesi i "Bestseller" kur ai ishte vetëm 28 vjeç. Bilanci deri

"Shqiptarët gangsterë", reagon ambasadori shqiptar në Londër

Romani i fundit erotik shkruar nga britanikja El James ka shkaktuar reagin diplomatik, pasi ambasadori i Shqipërisë në Britani Qirjako Qirko ka reaguar për portretizimin që iu bëhet në libër shqiptarëve. Libri i ri i "Fifty Shades of Gray", "The Mister", përshkruan një pastruese të varfër shqiptare si viktimë e gangsterëve dhe trafikimit seksual, të cilët mrekullohen nga jeta në Britani të Madhe. Ambasadori Qirko shprehet se libri krijon perceptime shumë negative mbi shqiptarët, duke i bërë ata si "kriminelë primitivë" dhe krijon perceptime negative mbi etninë shqiptare. Qirjako Qirko, duke folur për "The Tepegraph" tha se personazhet shqiptarë në libër janë jorealë. "Më vjen keq që ekziston i tillë roman që krijon perceptim negativ për vendin tim. Shqiptarët janë njerëz më të mirë dhe më miqësorë nga se portretizohen në atë roman. Qirko u shpreh se ka më shumë se 120 mijë shqiptarë në Britani dhe sigurisht që ka individë që kryejnë krime, por nuk mund të përgjithësoh. Në libër ka një personazhe shqiptare që quhet Alesia Demaçi, e cila punon si pastruese në një shtëpi aristokratike britanike. Alesia, sipas historisë së librit, u trafikua në Britaninë e Madhe. Ajo, gjithashtu, përballet me presion të dhunshëm të babait të saj për t'u martuar me të fejuarin e saj, i cili dëshiron që ajo të jetë një 'grua tradicionale shqiptare', raporton "Daily Mail". "Bosët shqiptarë të turizmit janë përpjekur të rrisin reputacionin e vendit me një fushatë të titulluar "Taken By Albania". Titulli është një referencë ndaj filmit "Taken" në të cilën vajza e Liam Neeson është rrëmbyer nga kontrabandistët shqiptarë. Zyrtarët e turizmit pranojnë se Shqipëria është parë si një paraajsë për banditë, kriminelë dhe gangsterë në kulturën popullore. Por ata këmbëngulin se reputacioni i vendit është tërësisht i pavërtetë, duke thënë se Shqipëria është një vend "i bukur dhe tepër i sigurt për të vizituar dhe jetuar".



më tani tregon se 7 bomba vetëvrasëse vranë të paktën 290 njerëz në një sulm të koordinuar në një hotel me 5 yje dhe kisha gjatë pashkëve të së dielës. Munisha Gunasekera, komisioneri i

Sri Lankës për Britaninë, u shpreh se të paktën 8 persona me kombësi britanike kanë ndërruar jetë gjatë sulmit. Ende asnjë grup nuk ka marrë përgjegjësi lidhur me sulmin.

SHKURT

Qipro arreston oficerin, vrases i dyshuar serial

Policia në Qipro po punon për të gjetur një vrases të mundshëm serial. Kjo pasi dy trupa grash të vdekura janë gjetur dhe një vend të shkretët dhe një fëmijë 6 vjeç ka humbur. Viktimat janë gjetur në periferinë e kryeqytetit të vendit, Nikozia. Një prej viktimave të zhdukura është një grua 36 vjeçe nga Filipinet. Një viktimë e dytë, e gjetur vonë të shtunën, mendohet të jetë një 28-vjeçar nga Filipinet, i cili, gjithashtu u raportua i zhdukur vitin e kaluar, megjithëse nuk është identifikuar përfundimisht, raporton "Reuters". Një oficer karriere 35-vjeçar është në paraburgim nën dyshimin e vrasjes të të tre personave. Të dyja gratë kishin punuar në Qipro, e cila ka një popullsi të konsiderueshme filipinase. Qipro u tronditi nga ngjarja e pazakontë dhe kriminale. Oficeri u arrestua, pasi autoritetet gjetën kontakte me tij dhe grave të vrara barbarisht. **Juncker do t'i luftojë "lajmet e rreme" para zgjedhjeve europiane**
Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, u zotua se do të godasë çdo "lajm të rremë" gjatë fushatës për zgjedhjet e Parlamentit Evropian, që do të mbahen në maj. "Nëse qeveritë bëjnë pretendime për Bashkimin Evropian ose Komisionin, të cilat nuk korrespondojnë me të vërtetën, atëherë do të përgjigemi", tha Juncker në një intervistë për grupin mediatik Funke të Gjermanisë. "Unë tashmë kam parë përpjekje për të ndikuar zgjedhjet e Parlamentit Evropian me manipulime, që vijnë nga disa kënde, jo vetëm jashtë BE-së. Edhe shtetet brenda BE-së po bëjnë përpjekje të drejtojnë vullnetin e elektoratit me lajme të rreme", tha Juncker, duke mos folur me emra konkretë. Sipas tij, Komisioni "është i përgatitur për t'i luftuar të gjitha". Zgjedhjet për Parlamentin Evropian do të mbahen nga data 23 deri më 26 maj. Pjesëmarrja në to ka rënë vazhdimisht gjatë viteve të fundit, derisa partitë euroskeptike kanë shënuar fitore të mëdha.

Talentja shqiptare që mahniti botën

Vivian Biagioni:

Emocionet e "Sanremo Junior", ja si e pritën këngën time të parë

"Çmimet jua fal, vendin tim jo, falënderuese familjes"



Egla Xhemali

Ajo është vetëm 16 vjeçe dhe ka prekur skenat muzikore që kur ishte 6 vjeçe. Vivian Biagioni tashmë i ka pushtuar ato me talentin e saj. Portofolin e çmimeve e ka plot me trofe të festivaleve brenda dhe jashtë vendit, të cilat ajo i ruan me fanatizëm. Vetëm prej pak kohësh Biagioni ka publikuar klipin e saj të parë me titull "Giove contro" (Jupiteri kundër), i cili është sa i thjesht, po aq artistik. Idhulli i saj është Demi Lovato. Stili, potencia e zërit si dhe zotërimi i jash-tëzakonshëm i emocioneve që të jep skena janë disa prej komponentëve të Lovatos që Vivian adhuron më tepër. Për "Gazeta shqiptare" vjen një rrëfim i zonjushës simpatike për botën magjike të muzikës dhe për ëndrrat e saj. Ajo është shembulli më i mirë për të gjithë ata që luftojnë për t'u rritur profesionalisht dhe për të pasur sukses që në hapat e parë në botën e vështirë, por dhe magjike, në muzikë.

Vivian, sjell klipin tënd të parë. Si e shikon ti këtë këngë dhe klip, është pëlqyer nga publiku?

Mendoj se po! Kënga u pëlqye shumë nga juria dhe konkurentët. Sigurisht që "Giove Contro" është një këngë e stilit italian modern.

Cilët ishin bashkëpunëtorët që realizuan këtë projekt?



Të them të vërtetën ky projekt ishte i paparashikuar. Mora një çmim "Canzone Inedito" në një spektakël televiziv në Romë dhe menduam ta prezantojmë këngën dhe videoklipin në "Area Sanremo", "Sanremo Giovani" ku dhe arrita të kualifikohem në finale. Për mua ishte një arritje, pasi isha dhe më e vogla në moshë.

Pra, le të themi që je zyrtarisht pjesë e tregut muzikor, ke ndonjë plan specifik?

Planet e mia janë pjesëmarrja në aktivitetet televizive live dhe koncerte

live. Kam shkruar tekste dhe muzikë e vazhdoj të shkruaj. Mendoj të filloj bashkëpunimin për realizimin e tyre!

Ke konkurruar në Sanremo Junior. Kjo ndoshta një fillim i mbarë për festivalin e madh Sanremo?

"Area Sanremo" është një mundësi për të arritur "Sanremo Giovani" ku dhe vetëm 2 këngë futen në "Sanremo Big", por për mua ishte një eksperiencë e bukur që do të vazhdojë ende më tej.

Ke terren dhe në Shqipëri. Do vazhdosh të kultivosh këtu, apo tani po



mendon vetëm për Italinë?

Mendoj se po, Shqipëria është vendlindja ime dhe kam shoqërinë e kujtimet më të bukura. Në Shqipëri provova skenën që në moshën 6 vjeçe dhe kam një formim artistik dhe kulturor. Do jem këtu, atje, do jem gjithandej. Çmimet jua fal, vendin tim jo. (qesh)

Çfarë ka në horizontin tënd muzikor?

Shikoj zërin tim dhe këngën time që i kalon kufijtë e horizontit. Zëri që del nga shpirti dhe prek shpirtin e mijëra njerëzve e kjo nuk ka kufij.

Kë falënderon Vivian



për të gjitha këto arritje?

Prindërit e mi, të cilët më mbështesin me sakrificat dhe lodhjen duke më shoqëruar në çdo aktivitet dhe profesionistët me të cilët punoj aq shumë për të ecur përpara artistikisht.

Edhe pse je vetëm 16 vjeçe, ke ndonjë keshillë për moshatarët e tu që duan t'i hyjnë muzikës?

Bota e muzikës është vështirë, ka shumë emocion, por do t'iu thosha vetëm nëse e dashurojnë më të vërtetë dhe me shpirt mund t'ia dalin.

Dimë që idhulli yt është Demi Lovato. A do doje një

bashkëpunim me të dhe nëse po si e ke gdhendur atë në mendjen tënde?

Normal që e kam menduar shumë, por duhet të punoj shumë akoma. Bashkëpunimin do ta bëj kur ta ndajmë skenën bashkë dhe unë të kem arritur nivelin e Demit. Do punoj fort dhe jam e sigurtë që momenti do vijë vetë.

Në ëndrrat e tua është skalitur një skenë që e dëshiron gjatë gjithë kohës?

Unë ëndërroj shumë. Në ëndrrat e mia ka turne nëpër bote dhe koncerte në stadiume të mëdha, ëndrra adoleshence. (qesh)

Kejvina Kthjella zbulon për herë të parë "dashurinë e komplikuar" të saj

Kejvina Kthjella është padyshim një prej vajzave më të përfolura në showbiz-in shqiptar dhe ndonëse është larguar nga ekrani shqiptar, ish-velina e "Xing me Ermalin", vazhdon të ketë një vëmendje të jashtëzakonshme me çdo lëvizje që bën. Së fundmi, Kejvina ka komunikuar nëpërmjet 'Instastory' me fansat e saj ku dhe ka ndarë publikisht problemin e saj të madh. Kejvina ka rrëfyer se ndodhet mes një zgjedhjeje të vështirë, pasi nuk vendos dot se në cilin vend është më mirë të jetojë, në Shqipëri apo në Itali, pasi i dashuron të dy shtetet. "Më mirë në Itali apo më mirë në Shqipëri?" - e pyet ndjekësi të cilit Kejvina ia kthen: "S'di. Kur vij në Itali më mungon Shqipëria. Kur jam në Shqipëri më mungon Italia. Dashuri e komplikuar." - shkruan velina në 'Instastory'.



Vetëm shok apo diçka më tepër? Morena flirton hapur me reperin amerikan

Morena Taraku është gjithmonë në qendër të vëmendjes për jetën e saj private mjaft luksoze dhe shpenzimet marra-mendëse që gjithmonë preferon t'i ndajë me fansat në rrjete sociale. Së fundmi, bukuroshja ka shpërndarë një video nga koncerti i reperit Tyga duke treguar se është një fanse e zjarrtë e tij, por edhe duke dhënë shenja se ajo është më e afërt me të se ç'duket. Në një seri videosh në "Instastory" kjo e fundit tërhoqi mjaft vëmendje. Këngëtarja ka shpërndarë disa pamje ku duket mjaft e afërt me ish-të dashurin e Kylie Jenner, Tyga dhe më poshtë mbishkrimi: "Fuck You Paparazzi", duke i bërë tag edhe reperit. Një moment i dyshimtë ky dhe të gjithë presim një shpjegim nga Morena për këto pamje të kapura mat nga paparazzi.



Si ju duket? Fero ka bërë ndryshimin drastik në pamje

Reperi Fero dhe partnerja e tij, Arbenita Ismaili, janë kthyer në një ndër çiftet më të komentuar të momentit, të cilët numërojnë mijëra ndjekës në profilet e tyre në rrjete sociale. Ata nuk ngurrojnë ta shprehin publikisht dashurinë për njëri-tjetrin duke tërhequr gjithmonë vëmendjen e publikut, mirëpo para pak ditësh një tjetër detaj në fotot e Feros ka tërhequr vëmendjen e fansave. Fero ka bërë ndryshimin drastik në look duke i lyer flokët 'neon' dhe me siguri askush s'e ka njohur reperin në pamje të parë. Por, fansat të cilëve nuk ju shpëton asnjë detaj e kanë gjetur se nga kush është inspiruar Fero për këtë ndryshim dhe bëhet fjalë pikërisht për Eminem. Reperi me famë botërore, vite më parë ka luajtur me "look"-un e tij duke u kthyer në një biond platin.



Roberti pajtohet me Tunën? Ja veprimi që i habiti të gjithë

Patris Berisha dhe Tuna janë një ndër çiftet më simpatikë shqiptarë dhe dashuria e tyre është bekuar me një djalë të quajtur Tian. Së fundmi Patrisi ndau në 'Instagramin' e tij një foto teksa me Tianin mbi shpinë dhe Tunën në krah janë duke bërë 'hiking' (ngjitje mali). Ata shfaqen me rroba sportive dhe shumë të lumtur, ndërkohë që këtë foto mund ta përdorim edhe si një mesazh për shumë prindër, pasi shumë prej tyre s'do guxonin ta merrnin fëmijën e tyre në një aktivitet të tillë. Ajo që ka tërhequr vëmendjen në foton e çiftit është se vëllai i Patrisit, Robert Berisha e ka pëlqyer këtë foto. Siç dihet ai dhe Tuna nuk kanë marrëdhënie fare të mira dhe shërr mes tyre ka marr një vëmendje të madhe në media. Madje para pak ditësh kur u pyet për albumin e ri të Tunës, Roberti i tha që është një kopje e Elvana Gjatës.



PASHKET JAVA

Nga *Miron Çako

Të krishterët ortodoksë, mba si kanë kreshmuar për dyzet ditë, festojnë të Dielën e Palmave ose Dafinave, kjo në përkujtim të Hyrjes së Krishtit në Jerusalem. Me palma dhe dafina pritëshin në kohë të lashta mbretërit edhe fitimtarët e betejave. Në të njëjtën mënyrë u prit edhe Krishti si mbret i Izraelit, sepse me mrekullinë e fundit që bëri Krishti duke ngjallur mikun e tij Llazarin, i cili qëndroi në varr për katër ditë, Ai jo vetëm tregoi fuqinë e tij hyjnore si Perëndi-Njeri, por i dha një goditje të fortë vdekjes: armikut më të madh të gjithë njerëzimit, duke paralajmëruar kështu ngjalljen e Vet dhe të gjithë njerëzimit në ditën e fundit të botës, kur Ai përsëri do vij me lavdi Hyjnore për të gjykuar të gjithë njerëzit edhe ata që do kenë vdekur, duke i ngjallur si Llazarin dhe kështu vdekja do të mundet plotësisht.

E HËNA E MADHE

Sipas orës liturgjike, kur në të përdorur të diellit fillon dita e re, të krishterët ortodoksë në mbremjen e të Dielës së Dafinave, fillojnë Javën e Madhe më të shenjtë të vitit liturgjikal në Kishën Ortodokse, sepse të mëdha, të rëndësishme dhe të mistershme janë ngjarjet që kujtohen në ditët e kësaj Jave.

Shërbesat e Shenjta të Javës së Madhe fillojnë me shërbesat e Dhëndrit. Qohen kështu nga tropari i njohur nga të gjithë ortodoksët: "Ja se ku po vjen Dhëndri në mes të natës..." Emërtimin "Dhëndër" Perëndia ia jep vetvetes nga marrëdhënia e Tij me popullin e Izraelit: "Sepse krijuesi yt është dhëndri yt" (Isaia 54:5). Ky varg shpreh dashurinë e madhe bashkuese dhe me karakter erotik të Perëndisë me popullin e Izraelit, ashtu siç bashkohet dhëndri me nusen. Për më tepër ky emërtim i përshatet Krishtit i Cili si Biri i Perëndisë edhe Biri i Njeriut, e do me dashuri filijuese Kishën që përbëhet nga gjithë popujt e botës, që ta shpëtojë, ta pastrojë e ta shenjtërojë atë për vete në një bashkim të përjetshëm, sepse: "Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të, që ta shenjtërojë, pasi e pastroi me larjen e ujit me anë të fjalës, që ta nxjerrë atë përpara vetes të lavdishme, pa njolla a rrudha a ndonjë gjë të tillë, por që të jetë e shenjtë dhe e paqartueshme." (Efesianëve 5:25-27).

Historia e njerëzimit sipas Biblës, fillon me një martesë të Adamit me Evën: "Kështu Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltysë së vet, sipas shëmbëlltysë së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën. Dhe Perëndia i bekoji ata" (Zanafilla 1:27-28). Po ashtu, historia e njerëzimit të do të mbarojë me një martesë të Krishtit me Nusen e tij Kishën, në një bashkim të përjetshëm, në qiellin e ri dhe tokën e re: "Le të gëzojmë dhe të ngazëllohem dhe le t'i japim Atij lavdi, sepse erdhi dasma e Qengjit (Krishti) dhe Nusja e tij (Kisha) është përgatitur! Dhe i është dhënë të vishet me li

Java e madhe për të krishterët ortodoksë



të hollë, të pastër dhe të shkëlqyeshëm, sepse liri i hollë janë veprat e drejta të shenjtëve". "Lum ata që janë ftuar në gostinë e dasmës së Qengjit" (Zbulesa 19:7-8-9).

Lidhur me kuptimin e Krishtit si Dhëndër i shpirtit, na tregohet nga një tropar tjetër shumë i njohur, që psalet nga besimtarët ortodoksë çdo ditë të Javës së Madhe: "Nusëroren tënde shoh, o Shpëtimtari im të stolisur, edhe rrobë nuk kam që të hyj brenda në të, ndriçoma pra stolinë e shpirtit, Dritëdhënës dhe shpëtomë".

Krishti, Dhëndëri i Kishës, shfaqet para Nusës (Kishës) dhe dasmorëve (besimtarëve) i shpërfytyruar nga mundimet. Në vend të kurorës së artë, ka kurorë më gjemba, si simbol i mallkimit që mori toka nga mëkati i njeriut: "Dhe toka do të jetë e mallkuar ... ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore" (Zanafilla 3:18). Në vend të rrobës mbretërore, Ai shfaqet me rrobën e kuqe të talljes, simbol të mëkateve njerëzore, ashtu siç thuhet tek profeti Isaia: "edhe sikur mëkakat tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora, edhe sikur të ishin të kuqe të purpur, do të bëhen si leshi." (Isaia 1:18) Në vend të skeprtit mbretëror, mban kalamin, simbol i egoizmit dhe rebelimit dhe njerëz: Krishti duke marrë mbi vete mallkimin, egoizmin, krenarinë, rebelimin dhe çdo mëkat tjetër njerëzor, pagoi për të gjitha me dashurinë e tij filijuese në kryq.

Të Hënën e Madhe e të Shenjtë, të krishterët përkujtojnë gjithashtu dhe mrekullinë e tharjes së pemës së fikut, që u mallkuar, sepse Krishti: "duke parë nga larg një fik që kishte gjethe, shkoi për të parë nëse mund të gjente diç-

ka atje; por, kur iu afrua, s'gjeti asgjë përveç gjetheve, sepse nuk ishte koha e figjeve. Atëherë Jisui, duke iu drejtuar fikut, tha: Askush mos ngrënë kurrë fryt prej teje përjetë" (Mark 11:13-14). Mrekullia që një paralajmërim për Izraelin, i cili kishte një fe ritualiste vetëm me gjethe, d.m.th. ceremoni pa frytë besimi. Për këtë Izraeli u braktisë nga bekimi i Perëndisë dhe u mallkuar si komb, por dhe një paralajmërim për të krishterët, që të mos përfundojnë në një fe ceremoniale, por pa frytë e Shpirtit Shenjtë që janë: dashuria, gëzimi, pagja, durimi, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia dhe vetëkontrolli. Kundër këtyre gjërave nuk ka ligj." (Galatasve 5:22-23).

E MARTA E MADHE

Edhe në Martën e Madhe kryhet shërbesa e Dhëndrit sipas troparit: "Ja se ku vjen Dhëndri dhe lum shërbëtori, që do ta gjejë të zgjuar, dhe mjerë ai të cilin do ta gjejë mendjefjetur. Shiko pra, o shpirtit im, mos mundesh prej gjumit që të mos jesh tek vdekja dhe të mbyllesh jashtë mbretërisë; po zgjuhu duke thirrur i Shenjtë, i Shenjtë, i Shenjtë, je, o Perëndi, me ndërmjetim të Hyllindësës, mëshirona".

Ky tropar ka lidhje me dy shëmbëlltira të mësuara nga Krishti; ajo e Dhjetë Virgjërëshave (Mateu 25:1-13) dhe Shëmbëlltira e Talantave (Mateu 25:14-30), të cilat u kujtojnë të krishterëve, se besimi pa vepra është i pavlerë dhe se besimtarët duhen të jenë gati me besim edhe vepra në çdo kohë, për të pritur Krishtin në ardhjen e tij të dytë, që do të jetë e papritur për çdo njeri edhe për gjithë njerëzimin, ashtu si Krishti paralajmëron: "Rrini zgjuar pra se nuk e dini në cilën orë do të vijë

Zoti juaj" (Mat. 24:42).

E MËRKURA E MADHE

Të Mërkurën e Madhe atmosferën e kishës e mbush pendimi prekës dhe mirënjohja e gruas mëkatore, që leu me miro këmbët e Krishtit. Për këtë ngjarje na informon Ungjilli sipas Lukait: "Edhe ja, një grua në atë qytet, e cila ishte mëkatore, kur mori vesh se kishte ndenjur në shtëpinë e Fariseut, pruri një alabastër me miro. Edhe ndenji prapa pranë këmbëve të tij duke qarë, edhe zuri të lagte këmbët e tij me lot, edhe ia fshinte me flokët e kokës së saj, edhe puthte këmbët e tij, edhe ia lyente me miro" (Luka 7:37-38).

Por në këtë ditë kujtohet edhe mirënjohja e Marias motrës së Llazarit që hodhi mbi kokën e Jisuit një vaj shumë të shtrenjtë që kushtonte 300 dinarë: "Tani, kur Jezusi ishte në Betani, në shtëpinë e lebrozit Simon, iu afrua një grua me një alabastër me vaj të parfumuar shumë të kushtueshëm, dhe ia derdhi mbi kokën e tij, kur ai po rrinte në tryezë. (Mateu 26: 6-8)

Ky ishte një shpenzim shumë i madh, paga e rreth një viti pune, por aspak i mjaftueshëm për mirënjohje ndaj Krishtit që ishte miku i mëkatarëve. Maria me këtë veprim paralajmëroi vdekjen dhe varrimin e Jisuit. Hebrejtë e kishin zakon që të vdekurit, para se t'i varrosnin, i lyejnë me miro. Pavarësisht se u keqkuptua veprimi i saj dhe u përfol nga nxënësit si shpenzim i tepërt: "Kur e panë këtë gjë dishepujt e tij u zemëruan dhe thanë: "Përse gjithë ky shpenzim i kotë? "Ky vaj në fakt, mund të shitej shumë shtrenjtë dhe paratë tu jepeshin të varfërve" (Mateu 26: 8-9), por Krishti u tha: "Pse e shtetësoni këtë grua? Ajo kreu në fakt një veprë të mirë ndaj meje. Sepse të varfrit do t'i kenë përherë me ju, por mua nuk do të më kenë përherë. Sepse, duke derdhur këtë vaj të parfumuar mbi trupin tim, ajo e bëri për ta përgatitur trupin tim për varrim. Në të vërtetë unë po ju them se kudo që do të predikohet ky ungjill, në gjithë botën, do të tregohet edhe çfarë bëri kjo grua, në përkujtim të saj" (Mateu 26: 10-13).

Kjo fjalë e Krishtit është vërtetuar, se sa herë që lexohet ky Ungjill dhe çdo të Mërkurë të Madhe, kujtohet ky akt adhurimi, falënderues dhe mirënjohës i Marias ndaj Krishtit. Akti i Marias përligjë të gjitha dhurimet e shtrenjta që besimtarët mirënjohës i kanë bërë prej shekujsh Kishës, Trupit të Krishtit.

Ngjarje tjetër që kujtojnë të krishterët në të Mërkurën e Madhe është marrëveshja që bëri Juda Isakarioti, nxënësi i Jisuit, me kryepërfiterinjtë për të tradhtuar



Krishtin: "Atëherë një nga të dymbëdhjetët, ai që quhej Juda Isakarioti, shkoi te kryepërfiterinjtë e tha: Ç'do të më jepni, edhe unë t'jua dorëzoh juve atë? Edhe ata i numëruan tridhjetë monedha argjendi. Edhe që atëherë kërkonte kohën e duhur ta dorëzonte" (Math. 26:14-16).

30 monedha argjendi ishte çmimi i një skllavi, që sot ka vlerën e rreth 20 dollarëve. Asnjë nga nxënësit e Krishtit, pavarësisht se kishin dobësitë e tyre, nuk u rrëzuan si Juda që ishte lakmues parash, prandaj apostull Pavli paralajmëron të krishterët: "Sepse lakmia përpara është burimi i gjithë të këqijave dhe duke e lakmuar atë fort, disa u larguan nga besimi dhe e tejshpuna veten e tyre me shumë dhimbje" (I Tim. 6:10).

Ditën e mërkurë në mbremje kryhet për të krishterët edhe Misteri i Efqelisë. Lyerja me vaj të shenjtëruar kryhet që besimtarëve t'u falen mëkakat e bëri për ta përgatitur trupin tim për varrim. Në të vërtetë unë po ju them se kudo që do të predikohet ky ungjill, në gjithë botën, do të tregohet edhe çfarë bëri kjo grua, në përkujtim të saj" (Mateu 26: 10-13).

E ENJTJA E MADHE

Të Enjten e Madhe në mëngjes në kishat ortodokse, kremtohen këto ngjarje të mëdha: larja e këmbëve të nxënësve nga Jisui dhe themelimi i Eukaristisë Hyjnore, agonia në Gjetsemani dhe arrestimi i Krishtit.

Ungjilli na tregon: "Jisui dërgoi Pjetrin dhe Joanin në qytet duke thënë; Shkoni dhe na bëni gati Pashkën që të hamë" (Luka 22:8). Për judenjtë e Kremtja e Pashkëve ishte përkujtimi vjetor i gjithë historisë së tyre të kalimit nga skll-



lavëria e faraonit në Egjipt për në tokën e premtuar Abrahamit. Ata kujtonin në këtë darkë pasheke si paraardhësit e tyre, për t'i shpëtuar ndëshkimit nga engjëlli i vdekjes, i cili do të vriste të gjithë fëmijët e paranditë të egjiptasve, lypen trarët e shtëpive me gjakun e qengjtit. Atë natë ata hëngrën mishin e qengjtit me bukë pa maja dhe të veshur gati për rrugë, sepse ajo natë ishte Pashkë (kalim).

Jisui dhe nxënësit e Tij po hanin Pashkën një ditë përpara nga Pashka e judejve, që sipas kalendarit hënor, i binte të premtën në mbrëmje në ditën e 14-të të muajit Nisan. "Dhe ndërso pa hanin, Jisui mori bukën, e bekoji, e theu, dhe ua dha dishepujve dhe tha: Merrni, hani; ky është trupi im. Pastaj mori kupën, dhe falënderoi, dhe ua dha atyre duke thënë: Pini prej tij të gjithë, sepse ky është gjaku im, gjaku i Dhiatës së Re, i cili është derdhur për shumë për faljen e mëkateve." (Mateu 26:26-28).

Me fjalët: "Bëjeni këtë në kujtimin tim", Krishti i zhvendos nxënësit nga Pashka e judejve në atë Tijën, nga Beslidhja e Vjetër me gjakun e qengjtit, në Beslidhjen të Re me gjakun e Qengjit të Perëndisë dhe duke përbushur në veten e tij Pashkën, kalimin nga vdekja në jetë me anën e vdekjes dhe Ngjalljes së Tij, Krishti u kërkon nxënëseve edhe të gjithë atyre që do të besonin tek Ai me anë të apostujve, që të mblidhen së bashku në Darkë Mistike në kujtim të Tij, ku nëpërmjet Kungatës Hyjnore të ripërtëritë bashkimin unik me Atë deri në ardhjen e tij të dytë, ashtu si tha: "Kush ha mishin tim edhe pi gjakun tim mbetet tek mua edhe unë në atë" (Joani: 6-56).

Në këtë Darkë Mistike kungohet si apostujt e tjerë edhe Juda tradhtari, por tek ai si dënim hyri djalli që e largoi nga shoqëria e Zotit edhe apostujve dhe që në erërsirë për të tradhtuar Krishtin. Kështu besimtarët e pagëzuar dhe të përgatitur sipas rregullave strikte para kungatës me agjërime, që të mos bien në mëkat dhe të Judës kur kungohen në çdo Liturgji Hyjnore luten me pendim: "Në Darkën Tëndë Mistike, o Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar, se nuk do tua them armiqve misterin, as do të jap puthje si Juda. Por si kusari të thërres: Kujtomë, o Zot kur të vish në Mbretërinë Tëndë".

Në disa Kisha Ortodokse, si në Jerusalem, episkopi, zakonisht, u lan këmbët të 12 priftërinjve, një imitim i veprimt të përlur të Zotit Krisht, që lau këmbët e nxënëseve dhe të Judës tradhtarit, si një shembull unik i përlurësisë, shërbimit me dashuri ndaj tjetrit edhe kur ky është armiku yt.

E PREMTJA E ZEZË

Të enjten në mbrëmje Kisha ortodokse në të gjithë botën kremton të Premtën e Madhe dhe sipas popullit quhet e Premte e Zezë. Në këtë ditë të së Premtes së Madhe, të krishterët kujtojnë pësimet e Krishtit: talljet, rrahjet me kamxhik, kurorën me gjemba, kryqëzimin, gozhdët, etjen, uthullën, heshtjen, braktisjen, dhe të gjitha sa duroi Krishti në Kryq.

Por në të njëjtën kohë, pësimi dhe vdekja e Krishtit në Kryq nuk është i ndarë nga Ngjallja. Madje edhe në këtë ditë të përlurës së thellë të Krishtit deri në vdekje kryqit, të krishterët shohin edhe zbulimin e lavdisë së Tij të përjetshme si Zotit i lavdisë me anë të

fjalëve që vet Zoti tha: "Dhe unë, kur të jem ngritur lart nga toka, do t'i tërheq të gjithë tek unë" (Joani 12:32). "Edhe pak kohë dhe bota nuk do të më shohë më, por ju do të më shihni; sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni. Atë ditë do të mësoni se unë jam në Atin tim, dhe se ju jeni në mua dhe unë në ju." (Joani 14:19-20). Kryqi dhe Ngjallja janë aspekte të një akti të pandarë unik shpëtimi. Të krishterët këndojnë këtë ditë: "Kryqi yt, o Zot, është jetë dhe ngjallje".

Himnet e Shërbesës së Mëngjesit të së Premtes, marrin një formë të veçantë me leximin e Dymbëdhjetë Ungjijve, pjesë të zgjedhura nga katër Ungjijtë që na informojnë për pësimet e Krishtit. Mbasi lexohen gjashtë ungjijtë e parë, në kishë fiket të gjitha dritat, duke krijuar një ambient të zishëm, prifti që kryeson shërbesën mban një kryq të madh dhe me një litani e vë kryqin me Krishtin e kryqëzuar në qendër të kishës, duke kënduar himnin: "Sot varet mbi dru, ai që vari dhenë mbi ujërat. Me purpur të gjenshtër vishet ai që veshi qiellin me re. Shuplaka duroi ai që çliroi Adamin në Jordan. Me perona u mbërthe Dhëndri i Kishës. Me shtizë u shpua biri i Virgjëreshës. Ifalemi pësimeve të tua o Krisht. Rrëfena dhe Ngjalljen tënde të lavdëruar". Pastaj besimtarët shkojnë dhe e falen me heshtje ikonës së Krishtit të kryqëzuar, duke parë me sytë e tyre shprehjen më të madhe dhe unike të dashurisë së Perëndisë për njerëzit: "Sepse Perëndia e deshi aq shumë botën, sa dha Birin e tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson në të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme" (Joani 3:16).

Krishti i kryqëzuar është shembull frymëzimi për përbalimin e sfidave dhe padrejtësive: "Sepse për këtë ju u thirrët, sepse edhe Krishti vuajti për ne, duke ju lënë një shembull, që të ecni pas gjurmës së tij. Ai nuk bëri asnjë mëkat dhe nuk u gjet asnjë mashtrim në gojë të tij". "Kur e fyenin, nuk e kthente fyerjen, kur vuante, nuk kërcënoje, por dorëzohet tek Ai që gjykon drejtësisht. Ai vet i mbari mëkatet tona në trupin e tij mbi drurin e kryqit që ne, të vdekur për mëkatë, të rrojmë për drejtësi; dhe me plagët e tij ju u shëruar. Sepse ju ishit si dele endaceke por tani ju u kthyet te bariu dhe ruajtësi i shpirtit tuaj." (2 Pjetri 2:21-25). Po ashtu Kryqi Krishtit është mburja e fitores të së krishterëve kundrejt tre armiqve: djallit, botës dhe mëkatit: "Edhe ata që janë të Krishtit e kanë kryqëzuar mishin bashkë me pasionet dhe lakmitë e tij. Sa për mua, mos ndodhtë kurrë që unë të mburrem me tjetër gjë, veç kryqin e Zotit tonë Jezu Krisht, për të cilin bota është kryqëzuar tek unë edhe unë të bota" (Gal 5:24;6-14).

Në mëngjesin e të Premtes së Madhe, pas Orëve të Mëdha, një nga priftërinjtë del nga dera veriore e Hierores dhe i afrohet Kryqit, që qëndron në mes të Kishës. Pastaj, duke e zbritur nga Kryqi figurën e Krishtit, ai e mbështjell atë me një copë të bardhë dhe e shtrinë në Tryezën e Shenjtë. Priftërinjtë kështu improvizojnë zbritjen e trupit të Krishtit nga kryqi dhe varrimin nga Nikodhimi dhe Josifi Arimathiani, të cilët e morën trupin nga guvernatori Romak Ponti Pilat edhe e varrosën me të shpejtë në një varr të gërmuar në një



shkëmb, sepse në mbrëmje festohet e shtuna e Pashkës Judaikë.

Epitafi është një pëllhurë në të cilën është pikturuar ose qëndësuar figura e Krishtit të vdekur. Kjo e mbajtur nga priftërinjtë, vendoset në një varr të improvizuar dhe të zbkuruar me lule në qendër të Kishës dhe pastaj nderohet nga të gjithë besimtarët.

E SHTUNA E MADHE

Të Shtunën e Madhe, që në kishë kremtohet të premtën në darkë, të krishterët ortodoksë përkujtojnë varrimin e trupit të Krishtit dhe zbritjen e shpirtit të tij në Hadh (bota e të vdekurve). Gjatë ditës të së Shtunës së Madhe, të krishterët sodisin vdekjen e vetë vdekjes. Përgjatë kësaj kohe shohim trupin e Krishtit i cili prehet dhe pushon në varr; si një trim i Cili pushon mbas betejës dhe fitores kundër djallit. Besimtarët e shohim trupin tek pushon në varr, por me besim presin momentin kur Krishti do ngjallet. E gjithë kjo është shprehur në Shërbesën e së Shtunës së Madhe. Nota bazë e kësaj shërbesë nuk është kaq shumë vajtesë, pavarësisht se këndohen vajtimet, por më tepër një pritje e kujdesshme e Ngjalljes. Në fund të shërbesës, të gjithë ndjekin Epitafin e zbkuruar me lule jashtë kishës me litani përreth Kishës, siç është Tradita Ortodokse.

Kisha Ortodokse e quan këtë ditë e Shtuna e Bekuar e prehes së trupit të Krishtit nga mundimet e Kryqit. Po kjo prehe është një prehe "aktive", sepse Krishti si shpirt hyri në kërkim të mikut të tij të vdekur, Adamit, i cili përfaqëson gjithë natyrën njerëzore që ra në tiraninë e vdekjes. Duke mos e gjetur atë në Tokë, Krishti zbrit në mbretërinë e vdekjes. Atje në Hadh, Krishti e gjen Adamin dhe Evën dhe u jep atyre dhe shpirttrave të burgosur përsëri jetë të re. Këtë të vërtetë kristologjike na e zbulojnë qartë troparet e Kishës Ortodokse: "Për Adamin edhe përmbi dhe ta shpëtosh por se gjeje, dhe atëherë në Ferr të zindër të vdekurit ke zbritur ta kërkosh". Kisha me anë të tropareve teologjike na tregon se Adami dëgjoi hapat e Krishtit që po zbriste në Hadh tha: "Unë këto hapa i njo, janë hapat e Zotit që kur i dëgova në Parajsë u fsheha se kisha mëkatuar, por në goftë se Zoti po zbrzet këtu ku jemi në të burgosur, kjo do të thotë se shpëtua".

Një fenomen hyjnor që e tregon haptazi se Krishti është Drita e Botës që ndriçoi hadhin edhe u dha liri shpirttrave të burgosur që besuan te Ai edhe priten si Shpëtimtar; është se të Shtunën e Madhe rreth orës 12:00, Patriarku Ortodoks i Jerusalisit, duke

mbajtur në duar 33 llambadha, që simbolizojnë 33 vitet e Krishtit në tokë, hyn në Kishën e Tërëshenjtë të Zotit Krisht në Kishën e Ngjalljes në Jerusalem. Llambadhat Patriarkut ia ndez vetë Zjarri Hyjnor; i cili zbrzet nga qielli si flakë ose del nga Varrri i Krishtit. Mbasi ndizen nga kjo Flakë Hyjnore qirinjtë e patriarkut orthodhoks, ai del nga varri me qirinjtë të ndezur si një dëshmi e Dritës së Ngjalljes që ndriçoi ferrin edhe tani ndriçon shpirttrave e besimtarëve.

Mbi këtë ngjarje të përvitshme, tregohet dhe një fakt historik. Në 1759 sulltan Murati i Jerusalemit, detyroi patriarkun ortodoks të Jerusalemit Sofronin e IV-të, të dalë jashtë Kishës së Ngjalljes bashkë me popullin ortodoks, sepse atë vit Dritën Hyjnore do ta merrnin armënë monofizitë, të cilët kishin paguar shumë para tek sulltan. Kronika historike tregon se Drita Hyjnore zbriti edhe atë vit, por nuk ia ndezi qirinjtë patriarkut heretik armen që rrinte brenda varrit, por kaloi për mes kishës së madhe, cau tejpërtej kolonën e portës qendrore, dhe ndezi qirinjtë patriarkut ortodoks dhe kështu përsëri besimtarët ortodoksë ishin ata që morën Dritën e Pashkës. Mbas kësaj ngjarje Sulltan Murati shkroi një ferman ku thuhet; "se vetëm patriarku ortodoks ka të drejtë të marrë Dritën e Shenjtë nga Varrri i Krishtit". Që nga ajo kohë deri më sot, askush nuk guxon të hyjë në Varrin e Krishtit, në ditën e Pashkës, përveç patriarkut ortodoks, i cili ja jep këtë dritë gjithë popullit ortodoks të mblodhur rreth varrit dhe me qirinjtë të ndezur brohoret me ngazëllim: "Drita e ortodoksëve! Drita e ortodoksëve".

Ky fenomen hyjnor është vula që jep vetë Perëndia Triadik, se me të vërtetë Krishti u Ngjall dhe këtë lajm hyjnor ka të drejtë t'ia dëshmojë me të vërtetë mbarë botës vetëm Kisha Apostolike Ortodokse e cila është hirplotë, Shtylla e së vërtetës, që vazhdon prej shekujsh duke i predikuar mbarë botës, besimtarëve, heretikëve, skizmatikëve, gnostikëve, ateistëve, me doktrinë e me shenja hyjnore, se Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!

E gjithë kjo dëshmi paskale simbolizohet me dritën e qiririt që besimtarët të mblodhur nëpër gjithë kishat e botës, presin në mesnatë në fillimin e ditës së Diele të Pashkës, ta ndezin qiririn nga prifti që shfaqet me një llambadë të ndezur nga drita e altarit të Kishës dhe që nga Dera e Bukur i fton të gjithë besimtarët: "Ejani merrni dritë prej dritës që s'përdon dhe lavdëroni Krishtin që u ngjall së vdekurish".

*Përgjegjësi i Zyrës së Katakizmit të Kryepiskopatës KO-ASH-it.

LIBRI

Dita Botërore e Librit, me dy shkrimtarë austriakë

Nga Silvana Leka

SË çdo vit më 23 Prill, POETEA, në bashkëpunim me autorë, përkthyes dhe institucione kulturore vendase dhe të huaja, organizon veprimtari letrare në kuadër të Ditës Botërore të Librit. Kjo ditë e veçantë e vitit 2019 i takon letërsisë austriake dhe shkrimtarëve më të njohur të saj, duke bërë të mundur që, në bashkëpunim me ambasadën austriake në Tiranë dhe me mbështetjen e Reiffeisen Bank, lexuesit shqiptar t'i paraqiten panorama e letërsisë austriake ndër vite, por duke u përqendruar më fort në disa prej vlerave më të spikatura që janë ofruar kohëve të fundit në fushën e librit austriak në gjuhën shqipe. Njihet tashmë origjina e kësaj dite, e cila i kushton vëmendje autorëve, përkthyesve dhe lexuesit, si dita që simbolikisht është e lidhur me emrat e shkrimtarëve të mëdhenj, si Servantes, Shekspir dhe Inca Garcilaso de la Vega. Kjo datë lidhet, gjithashtu, edhe me ditëlindje apo ditëvdekjet e disa shkrimtarëve të tjerë, gjithashtu, të shquar si Vladimir Nabokov, Manuel Mejia Vallejo, Maurice Druon, Haldor K. Laxness, Josep Pla. Në nderim të tyre dhe përjetim të kësaj dite janë krijuar gjeeste e rituale, si dhurimi i trëndafilave dhe i librave. Prej këtij burojnë shenja simbolike për ata që e blejnë librin e tyre të parë më 23 prill, duke themeluar kësajsoj bibliotekën e tyre të parë. Por mbi gjithçka, duke filluar që nga viti 1995 e në vijim, kjo ditë u caktohet enkas për të tërhequr vëmendjen e publikut drejt librit, për të nxitur edhe më shumë ata që shkruajnë, veçanërisht të rinjtë dhe ata që sapo kanë nisur të shkruajnë. Mbi gjithçka mbetet zbulimi dhe rizbulimi vit pas viti i kënaqësisë së leximit. Por nuk mbaron me kaq. Rrethi i të interesuarve zgjerohet pasi Dita Botërore e Librit lidhet edhe me mbrojtjen e të drejtave të autorit, duke fuar që në këtë ditë të veçantë veprimtarive t'i bashkohen e të bëhen faktorë edhe botuesit, librarët dhe punonjësit e bibliotekave.

Elementeve kushtuar leximit POETEA këtë vit i shton edhe përrurimin e letërsisë dhe autorëve austriakë përmes kartolinave letrare. Kjo veprimtari vjen si vijim krijues i programit të suksesshëm POETRYCARD, që u zhvillua vjet, përmes së cilit u përrua letërsia austriake dhe ajo shqiptare, si bë e njohur veprimtaria e përkthyesve që lidhin kulturat.

Kësajsoj, veç dhurimit të librave e leximeve, Dita Botërore e Librit 2019 në Tiranë zhvillohet edhe



Promovohen sot librat e Jutta Treiber dhe Christine Nostlinger

përmes dërgimit drejt njëri-tjetrit të kartolinave me portretet, ballinat e botimeve dhe fragmente nga krijimtaria e shkrimtarëve të njohur austriakë Robert Menasse, Jutta Treiber, Christine Nostlinger, Robert Seethaler, Thomas Bernhard...

Ajo që POETEA ofron këtë vit është jo vetëm e njohura nga austriake në Shqipëri, si Elfriede Jelinek, Rainer Maria Rilke, Georg Trakl, Erein Einzinger, Baron Nopsca, Joseph Roth etj, por edhe e panjohura, apo pak e njohura e kësaj letërsie. Këtë vit kartolinave letrare me krijim-

tarinë dhe portretet e R. Menasse, J. Treiber, Ch. Nöstlinger, R. Seethaler, Th. Bernhard u shtohet edhe një video që paraqet një panoramë të letërsisë austriake, duke filluar që me Heinrich von dem Tuerlin e deri te shkrimtarët bashkëkohorë austriakë Thomas Glavinic, Wolf Haas. Këtyre u shtohen edhe krijimtari e niveleve të larta letrare, autorët e të cilëve njihen pak ose aspak nga lexuesit shqiptar. Këto elemente dhe befasi të këndshme letrare bëhen të njohura përmes leximeve të lexuesve më së pari e më pas prej leximeve të përkthyesve të tyre në gju-

hën shqipe si Admra Poçi, Irena Nasi, Lindita Komani, etj.

Vetëm gjatë këtij viti Botimet POETEA kanë sjellë për lexuesin shqiptar dy romane nga letërsia austriake. I pari është "Konradi - djali i kurisë së konservës" shkruar nga Christine Nostlinger dhe romani "E përdhunuara", nga Jutta Treiber.

Të dy veprat e mirënjohura të letërsisë austriake janë pjesë e veprimtarive përruese të Ditës Botërore të Librit. Kritika letrare për romanin "E përdhunuara", përkthyer në 25 gjuhë të botës, ka theksuar se është vërtet një libër jo vetëm me titull të rëndë, por edhe me një ngjarje të tillë, pasi ajo çfarë i ndodh personazhit kryesor, Frankës e që mund t'i ndodhë kujtdo në moshën e saj, është një nga përvojat më tronditëse që ndodh në jetën e një vajze.

Teksa rrëfen mbi jetën dhe natyrën e shpënguar të Frankës, shkrimtarja austriake Jutta Treiber ngulmon të shprehjet se pas përvojave dramatike, si ajo e 17-vjeçares, vëmendja shkon jo vetëm ndaj fajtorit, por ndaj të përdhunuarës, jeta e së cilës nuk është dhe nuk ka se si të jetë si më parë.

Me stil të qartë, energjik dhe bindës, shkrimtarja e njohur austriake Jutta Treiber, e cila është nderuar me Çmimin Mbarëaustriak për Librin më të mirë për të Rinj në Austrinë dhe për të cilën Presidenti Federal Dr. Heinz Fischer është shprehur se: "Krijimtaria e shkrimtares Jutta Treiber e ka pasuruar ndjeshëm letërsinë në gjuhën gjermane dhe ka kon-


tribuar shumë në vendin kulturor që zë Austria në botë", i jep rëndësi faktit se sa e vështirë është të fitosh betejën e kthimit në "normalitet" dhe se për ta fituar këtë lartë duhet të bashkohen të gjithë, më së pari familja, shkolla, shoqëria, që përballimi i asaj që ndodhi të kthehet në çështje të të gjithëve, përfshi këtu dhe të rinjtë e adoleshentët.

Bashkë me këtë libër përruohet përmes leximeve edhe një tjetër vlerë e çmuar nga letërsia austriake: romani, "Konradi - ose djali konservës". Kjo veprë e shkrimtares austriake Christine Nostlinger, ky sukses botëror i jashtëzakonshëm, përkthyer në më shumë se sa 20 gjuhë, sjell pranë lexuesit shqiptar ndodhitë e një djali të dorëzuar gabimisht të dikush, që nuk e do e që bëhet gati ta kthejë mbrapsht. Kjo jo sepse Konradi është një djalë "i keq" apo "i prapë". Përkundrazi, mospranimi i tij ndodh sepse Konradi është një djalë i përkryer.

Përmes këtij romani mahnitës rrëfëhet për fëmijërinë dhe rritjen e fëmijëve, për dëshirat dhe prirjet e tyre të natyrshme dhe mbi pritshmëritë e mëdha të prindërve, të cilët, edhe pse i duan, ua ndërlikojnë jetesën prej fëmije. Ja pse Konradi nuk është fëmijë i zakonshëm, por një fëmijë "prej fabrike", prej të cilit kërkohet të jetë gjithmonë i pari, i shkëlqyer dhe i përsosur, si më thu. Po a i lipset kujt një fëmijë i tillë, që flet në mënyrë të automatizuar, përdor gjuhë artificiale, që bën vetëm pyetje, por që nuk di të luajë, nuk di të bëhet pis e të hajë një akullorë pa marrë 10 herë leje nëse duhet ta hajë? A duhet të jenë fëmijë të sjellshëm deri në lodhje, me rezultate të jashtëzakonshme në mësim dhe a kanë më të vërtetë ndonjë rëndësi këto kur ky fëmijë nuk rritet natyrshëm dhe njohuritë e shkollës nuk i hyjnë në punë për jetën?

Ky roman, një nga më të dashurit e fëmijëve në të gjithë botën, i nxit lexuesit të qeshin, ta lexojnë me zë të lartë, pavarësisht nëse kjo ndodh më 23 prill 2019, gjatë veprimtarive të Ditës Botërore të Librit apo organizimeve të ngjashme një herë në vit, apo do të vazhdojë edhe më gjatë, në kohën lexuesi mbetet sërish vetëm përballë autorit dhe librit.

Kësaj prirjeje i vjen në ndihmë edhe nisma e POETEKËS për t'u bashkuar me njëri-tjetrin përmes shkëmbimit të kartolinave letrare, falë të cilave lexuesi takon njëkohësisht autorin austriak, përkthyesit e tij, botuesit dhe vetë librin, që nuk është më thjesht një objekt fizik me shkronja, figura dhe numra faqesh, por një urë komunikuese, që na bashkon jo vetë gjatë një mbrëmjeje letrare, por na fton drejt leximit, bibliolisë dhe vlerave që mbart libri, kjo mrekulli që mund ta mbartin me vete.



PREMIERA

Filmi "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" shkon në Moskë

Tri prostituta, kafeneja ilegale dhe kryengritja e grave

Mbahet në Moscow International Film Festival premiera botërore e filmi artistik "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" me regji dhe skenar të Kushtrim Bekteshit. Në përzgjedhjen e 15 filmave në edicionin e 41-të të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Moskë, portali "Festival Film" e rekomandon edhe filmin shqiptar "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar". Ai u shfaq më 21 dhe është planifikuar me 24 prill për një projekcion të dytë. Producenti i filmit Mumin Jashari ka thënë për median se me Kushtrimin do jenë në festival për prezantimin e filmit.

Ky është një sukses për regjisorin Kushtrim Bekteshi, i cili me film debutant po prezantohet në një festival të kategorisë A. Filmi është xhiruar në fshatin Gjonomad të rrethit të Korçës. Në film është paraqitur jeta e zakonshme dhe e qetë e një fshati "të harruar" që e rregullon ardhja e tri prostitutave në kafenenë ilegale të dy vëllezërve. Burrat, edhe përkundër përpjekjeve të grave të tyre për t'i ndaluar, tërë kohën e kalojnë në kafene duke harxhuar paratë e fundit në alkool dhe seks. Në shkollë mbizotëron gjendje kaotike, xhamia mbetet pa besimtarë. Nga e gjithë kjo gjendje kaosi përfitojnë dy të rinjtë Agimi dhe Shpresa, të cilët arrijnë të realizojnë lidhjen e dashurisë që ua kanë ndaluar prindërit e tyre.



Ndër klientët e rregullt në kafene është edhe i papuni Xharra, i cili me gruan e tij Hanën (e cila është shtatzënë) ka tre fëmijë të vegjël. Hoxha e humb autoritetin tek burrat e fshatit. Përveç pleqve, askush tjetër më nuk shkon në xhami. Edhe përkundër thirrjeve të tij apokaliptike për katastrofën që i kanoset fshatit, prapë se prapë kafeneja vazhdon me punë. "Spiuni" i fshatit (Avdili) përpjket që ta përmbushë misionin që ia ka ngarkuar Xhinga për ta vënë në tundim Hoxhën që edhe ai ta vizitojë kafenenë. Ndërkaq që gratë e fshatit detyrohen vetë të përkujdesen për fëmijët, shtëpinë, arat dhe gjithçka tjetër. Përpjekjet e tyre për t'i ndaluar burrat për të shkuar në kafene, rezultojnë të pasuksesshme. Në fund Hana me ndihmën e Hoxhës dhe gruas së tij, arin t'i organizojë gratë e fshatit që të rebelohen, të ndërmarrin aksion për t'i dëbuar prostitutat dhe për ta djegur kafenenë. Kafeneja digjet e tëra, ndërsa jeta në fshat ka gjasa të kthehet përsëri në normalitet.

"E veçanta në film, të gjithë aktorët flasin me një dialekt, edhe pse janë nga Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Flasin në dialektin geg, dhe kjo është një nga risitë e filmit tonë. Nuk bëhet fjalë se në cilën trevë bën fjalë, por që është përgjithëse për shoqërinë shqiptare, është një shoqëri patriarkale, por në ndryshim, ka mesazhin pozitiv brenda saj. Ndryshimi është i domosdoshëm për një shoqëri të caktuar", ka thënë producenti Genc Përmeti.

Në film është përfshirë një kastë e madhe aktorësh nga Maqedonia,

Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria, ndër të cilët: Shkumbin Istrefi, Osman Ahmeti, Ndrim Xhepa, Luan Jaha, Salaetin Bilall, Muzbajdin Qamili, Vjollca Bekteshi Hamiti, Adriana Matoshi, Diana Spasova, Hismet Ramadani, Musa Isufi, Ervin Bejleri, Romir Zalla, Adrian Aziri, Bujar Ahmeti, Shengyl Ismaili, Donikë Ahmeti, Taulanta Jupii, Mona Mustafa, Sokol Hajrullai, Ilire Vinca, Vebi Qerimi, Adem Karaga, Muzafar Etemi, Besmir Bitraku, Gentë Ratkoceri, Lili Çavdarova Suceva, Amernis Nokshiqi Jovanovska, Emine Kadriu, Flora Kadriu, Blerim Dardhishta, Muhamed Arifi, Mendim Murtezi, Teuta Ajdini Jegeni, Drita Kaba Karaga, Elhame Bilalli, Hajrullah Ramizi, Zijadin Murtezi, Vaske Niço, etj...

Filmi "Pranverë e paharruar në fshatin e harruar" është bashkëprodhim në mes Manufaktura Production (Maqedoni) me producent Sasho Pavlovski, Media&Film Production (Kosovë) me producent Mumin Jashari, Ska-Ndal Production (Shqipëri) me producent Genc Përmeti dhe Skupifestival (Maqedoni) me producent Muzbajdin Qamili dhe Osman Ahmeti. Filmi është i mbështetur financiarisht nga Agjencioni për Film i Maqedonisë, Qendra Kinematografike e Kosovës, Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë, Radiotelevizioni i Kosovës, Radiotelevizioni i Maqedonisë 2 dhe Radiotelevizioni i Shqipërisë.

Filmi është parashikuar të jetë pranë publikut në tërë kinematë tona në mesin e muajit maj 2019.

OLEN CESARI

DY NET KONCERT NË PALLATIN E KONGRESEVE

Rikthehet në Shqipëri "Olen Cesari & International Clandestine Orchestra", pas dy vjetësh nga koncerti i tij i fundit në Tiranë, event që ishte një sukses i madh publik dhe televiziv. Koncerti do të mbahet në datat 23 dhe 24 prill në Pallatin e Kongreseve në orën 19:00. Çezari ndërkohë ka vazhduar xhiron e botës me grupin e tij muzikor duke shfaqur koncerte në SHBA, Kanada, Brazil, Zvicër, Francë nga njëra anë e globit, por edhe nga ana tjetër si Vietnam, Tailandë, dhe Kinë. E paharueshme ishte performanca dhe prezantimi i tij në Carnegie Hall, në New York, me një orkestër prej 80 elementësh dhe 200 artistësh në kor. Të panumërtat janë edhe koncertet e tij nëpër botë, duke përfaqësuar Shqipërinë dhe Italinë nëpërmjet Instituteve Kulturore dhe "Performing Art Centers" (Qendra e Performimit të Artit) nëpër botë. Për t'u mos har-

ruar është "Ave Maria" që ekzekutoi në Rio de Janeiro mbi shtatullën e statujës së Krishtit. Çezari kthehet në Tiranë me grupin e tij "International Clandestine Orchestra" me qëllim që të përsëritë suksesin e kaluar dhe ta tejkalojë atë, duke rivënë në skenë një tjetër event të paharueshëm. Në koncert do të jenë të ftuar specialë: Alessandro Mannarino, Guo Gan, Pepe Sanchez, Eden, Shama Milan, Lavinia Mancusi-Bes Kallaku. Eventi si gjithmonë do jetë një miqs perfekt i këngëve dhe muzikës së mirënjohur të të gjitha trevave. Po ashtu do të ketë edhe pjesë të kompozuar nga vetë Çezari të shoqëruara me momente virtuozizmi total, por edhe gjallëri spontane duke futur në valle të futarit, si gjithmonë, të përfshirë totalisht në skenë me Çezari.

Personalisht kam menduar gjithmonë që të jem më i pranishëm në Shqipëri. Ju besoj e dini që për shkak të angazhimeve të shumta më duhet të udhëtoj dhe të zhvilloj evente e të performoj në

të gjitha anët e globit, por dëshira dhe detyra për vendim tim po më kthejnë sërish dhe do të më sjellin gjithmonë në Tiranë. Ndihem i ndëruar për interesin që kanë patur të gjithë shqiptarët për të ardhur në koncertin tim dhe ju garantoj të gjithëve se besimin e tuaj do t'ua kthej. Sot do të zbuloj vetëm disa detaje nga ato që do të ndodhin në koncert, sepse të tjerat do të jenë surprizë. Bashkë me grupin tim "International Clandestine Orchestra" do të rivendojmë në skenë tinguj nga e gjithë bota, e për ta na shoqëruar dhe për t'i bërë notat sa më reale unë kam ftuar Alessandro Mannarino këntautorin e famshëm italian. Nga Kina do të vijë Guo Gan, një instrumentist, i cili do të luajë një nga meloditë më të famshme të Azisë. Vjen po ashtu për herë të parë në Tiranë bateristi që ka performuar për vite me Santanën, Pepe Sanchez. Do të jetë Eden, Shama Milan nga Kuba, Lavinia Mancusi dhe për të thyer muzikën në një moment, unë kam ftuar edhe aktorin shqiptar të humorit Bes Kallaku.

"EKTRANI I ARTIT"

VJEN NË EDICIONIN E TRETË

Art House organizon për të tretin vit radhazi festivalin "Ektrani i Artit" ku do bashkëtojnë filmi dokumentar mbi artin me atë eksperimental dhe videoartin. I nisur si një përzgjedhje filmash nga festivali fiorentin "Lo schermo dell'arte", këtë vit do bëjë bashkë një përzgjedhje filmash nga International Short Film Festival Oberhausen, Lo schermo dell'arte, koleksioni i videos dhe filmit të Van Abbe Museum, një përzgjedhje nga videoarti shqiptar i viteve të fundit, një grup filmash të shkurtër nga regjisorja gjermane Sylvia Schedelbauer si dhe një film me metrazh të gjatë nga artisti shqiptar Pleurad Xhafa. Një risi tjetër do të jetë shpërndarja e projekcioneve në orrorret e shtëpipe shkodrane ku do të gërsëtohet hapësira private dhe publike, atmosfera tradicionale dhe ajo bashkëkohore. Teatri



Migjeni do të mirëpresë ceremoninë e hapjes shoqëruar me përzgjedhjen e parë filmike e në vijim projekcionet do të vazhdojnë në hapësirat e Art House, oborri i shtëpisë së Pashko Vasës, i shtëpisë së Llanze dhe asaj të Kolë Idromenos, ku është hapur e para kinema shqiptare në fillim të shekullit XX. Programi filmik do të shoqërohet me momente muzikore në ambientet e Qendrës Rinore Arka me të ftuar të veçantë Kolë Lacën me projektin e tij Shkodra Elektronike.

Opinion i Ditës

Odë për Zonjën Tonë të Europës

Bernard Henri-Levy


(vijon nga faqja 1)

... Ajo është një thesar i qytetërimit, si për ata që besojnë në parajsë dhe për ata që nuk besojnë. Ajo përfaqëson Europën e bukurisë, shpresave të shenjta, madhësisë dhe fisnikërisë. Ashtu si ju, ashtu si kushdo, jam zemërthyer.

Tragjedia provokon një çorbë me kujtime. Gdhendja në përjetësi nga Viktor Hygo të katedrales tek Kurrizjoja i Notre Damit, sigurisht që të vjen ndër mend. Po ashtu edhe vargu i Luis Aragonit: "Asgjë nuk është aq i fuqishëm, as zjarri, as drita, teksa Parisi im sfidon rrezikun. Asgjë nuk është më e bukur, se ky Paris i imi".

Të kujtohet edhe një frazë hapëse nga Bodleri: "Jam bukur, o të vdekshëm, si një ëndërr në gur." Nuk është shkruar për Notre Damin, por qartazi mund të thuhet edhe për të.

Kujtimet shkojnë përtej fjalës së shkruar. Katedralja në vetvete ka qenë dëshmitare e shekujve të historisë franceze, përfshirë episode që janë pjesë e legjendës. Ka qëndruar me Francën përgjatë kalorësisë mistike, në lavdi dhe zymtësi. Mendoj për meshën e festës së çlirimit të Parisit në 1944 dhe pagëzimin e një motre më të vogël aty. Lotoj me të, ashtu si vajtoj me të gjithë të krishterët që iu desh të shihnin kishën e tyre të përfshihej nga flakët, duke marrë me vete mbase një pjesë të padukshme të



kishës për ta.

Të nesërmen në mëngjes, e mendova Notre Damin si Francën e Rezistencës. Ajo përfaqëson madhësinë gotike dhe qetësinë e Senës. Ajo është besimi dhe bukuria në një manifest të vetëm. Dhe, sigurisht, fjalët e Hygosë dhe Aragonit mbeten ende aty, duke kërcyer në kokën time prej të pagjumit. E pyes veten si do të përballem me ditën. Si do të përballemi me të nesërmen? Hygo më jep përgjigjen: "Koha është arkitekti, por njerëz-

it janë ndërtuesit."

Pasditë mund të shpresoj që zjarri të ketë përfunduar. Për një qytetar të Parisit, është torturë të shohësh imazhet e tmerrshme të zemrës së qytetit që është përfshirë nga dhuna e flakëve. Më shumë se një kishë është rrëzuar. Në një farë mënyre, Notre Dame është shpirti i njerëzimit në vetvete dhe një pjesë e atij njerëzimi është prekur tashmë.

Ne parisienët besonim që zonja jonë e rnderuar ishte e pavdekshme.

Megjithatë ja tek është, e rënë, e plagosur, e pashpresë kundrejt fatit, teksa ne të gjithë e shohim këtë ferr. Megjithatë përpara atyre imazheve të dhembshme, erdhi edhe një ndjesi mbështetjeje. Italianët, suedezët, irlandezët, spanjollët, kinezët dhe algerianët - të gjithë u bashkuan njëzëri me popullin e Francës. Ashtu si pas një sulmi, të gjithë thoshin "Je suis Paris" (Jam Parisi).

Së fundmi, teksa digjej, Notre Dame na kujtoi brishtësinë e his-

torisë dhe trashëgimisë sonë, pasigurinë e asaj që kemi ndërtuar dhe natyrën e fundme të Europës mijëvjeçare, atdheut të artit, ku Notre Dame është një nga trashëgimitë më të vyera.

Duke parë nga e ardhmja, çfarë duhet të mendojmë? Çfarë duhet të bëjmë? Duhet të shpresojmë se sakrificat e Notre Dame do të zgjojë ndërgjegjet e përgjumura; se, përmes kësaj katastrofe, njerëzit do të kuptojnë se Europa është Notre Dame e shkruar me të mëdha. Më shumë se një bashkim politik, është një veper arti, një bastion brilant i inteligjencës së përbashkët, por, gjithashtu, shtëpi e një trashëgimie të vënë në rrezik.

Kjo trashëgimi është tepër e rëndësishme për t'u humbur. Nuk mund të lejojmë shkatërrimtarët të përcajnë popullin e Europës. Duhet të kemi parasysh se, së bashku, jemi ndërtues të tempujve dhe pallateve, krijues të së bukurës. Ky është mësimi i Notre Damit në këtë Javë të Shenjtë.

Presidenti francez, Emmanuel Macron, i cili për dy vjet ka bërë apel për bashkim në rindërtimin e Europës, tani po bën apel për bashkim në rindërtimin e Notre Dame. Së bashku, duhet të rikthejmë zemrën e Francës. Organizata ime letrare, La Règle du Jeu, do të kontribuojë në fondin kombëtar për këtë qëllim. I nxis të gjithë lexuesit të bëjnë të njëjtën gjë. Ne njerëzit jemi ndërtuesit.

Marrë nga Project Syndicate

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

Targeti rus për Shqipërinë është shumë i vështirë

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faja 1)

...ndërkombëtarisht që të eliminojë të gjithë këtë klasë politike të korruptuar?

2. Do ta ndihmojë Amerika Shqipërinë për ngritjen e një ushtrie moderne?

3. A do të nisë në Shqipëri reforma në arsim për ngritjen e intelektit shqiptar?

4. A do të kthehet Shqipëria pas eliminimit tërësor të klasës politike të korruptuar në qendrën reale të bashkimit arbëror në Ballkanin Perëndimor?

Sigurisht, të gjitha këto do të ndodhin me patjetër.


1. Gjithçka do të varet nga mendimi politik perëndimor për Shqipërinë, sidomos nga politika amerikane, e cila tani e ka thënë qartë se në interesin e saj përkundër politikës ruse në këtë zonë, kërkon domosdoshmërisht të përqendrohet në aleancë me politikën shqiptare.

Shqiptarët janë sot 97 për qind proamerikanë, kurse armiqtë shekullorë të tyre dhe pushtuesit e territoreve shqiptare, serbët, janë 80 për qind proruse.

Ngritja e të gjithë shqiptarizmit si frymë në Ballkanin Perëndimor është interes i madh i politikës amerikane dhe asaj gjermane. Në fakt, mu këtu duhet të kishte filluar politika e re shqiptare. Por në Tiranë, krerët e politikës janë kundër interesit kombëtar. Voldhën. Dhe tani duan të shkatërojnë Shqipërinë. Këtë duan të bëjnë. Por janë të mbaruar. Te Rusia e kanë shpresën. Si gjithmonë, njëlloj si shitësit e mëdhenj të interesit kombëtar shqiptar.

Por, sot e kanë të pamundur. Lodhen kot së koti e fare kot. Janë që në këtë ndërkohë kreyt të humbur.

II. Opozita që sheh nga Moska tani është e drobitur. Me një grusht të



paguarish mendoj të bënte kryengritje destabilizuese. Injorancë e asgjë më.

Po pse, Lul Basha dhe Sali Berisha do ta mundin në Tiranë politikën amerikane!

III. Gjithsesi, tani që parlamenti është i plotë dhe opozita antireformë nuk është më në parlament, politika amerikane dhe ajo gjermane e kanë të gjithë parlamentin nën kontroll dhe prandaj kuptohet se Reforma në Drejtësi tani e më tej nuk mund të ketë më asnjë lloj sprapsjeje dhe prandaj do ta vijojë strukturimin e saj juridik me shpejtësi.

Shqiptarët po presin me ethe pritëse reformën e premtuar nga Uashingtoni, ndërsa po kuptohet që Uashingtoni, krahas me vënien në vijë të vetë zhvillimit përfundimtar të Reformës në Drejtësi, ka filluar me ritme të shpejta edhe riarmatosjen moderne të ushtrisë shqiptare.

Të dy këto aspekte janë të lidhura me njëri-tjetrën dhe kanë një pikësypin kryesor: ngritjen e Shqipërisë dhe të botës shqiptare në Ballkanin Perëndimor deri në një faktor të rëndësishëm ndërkombëtar. Kjo ngritje ecën me forcë në një as-

pekt politik dhe ushtarak njëherësh, gjithë po në funksion të konfliktit me Moskën dhe më Beogradin. Sepse kjo do të jetë politika e njëzet vjetëve të ardhshëm. Është kjo arsyeja që sot pika më e nxehtë e konfliktit ruso-amerikan është Shqipëria, por çështja shqiptare ka fituar.

"Targeti rus për Shqipërinë është shumë i vështirë", tha me plot sarkazëm Zv.ndihmës Sekretari i Shtetit amerikan, Palmer, para disa ditësh në Tiranë.

Dhe kjo është e vërteta.

*** Marrë nga "Facebook".
Titulli është i redaksisë**

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të kalojnë një ditë pa probleme. Ka gjasa të përfundoni të gjitha detyrat. Ata që nuk janë të kënaqur me punën e tyre, rekomandohet të kërkojnë një tjetër vend pune. Megjithatë duhet të qëndroni larg ndryshimeve të tjera sot.

DEMI

Demët duhet të mendojnë pozitivisht. Mos kërkonti heroizëm të veçantë ndaj vetes në punë apo në shtëpi. Do të ishte mirë të bënit pushim këtë të martë ose të bëni ushtrime fizike. Bëni kujdes nëse nuk dëshironi të shkoni në një event që ju kanë ftuar.

BINJAKET

Pjesa më e madhe e Binjakëve do ta kalojnë këtë ditë me sporte të ndryshme ose mund të bëjnë një udhëtim të shkurtër. Nëse do të jetë e mundur, do të ishte mirë të mos e ngisni makinën sot, por të jeni pasagjerë.

GAFORJA

Gaforet rekomandohet të mendohen thëllë dhe të shohin mënyrat për të ecur përpara. Mos u bëni sipërfaqësorë, por përpunoni të analizoni gjëset dhe shprehjet e futyrës. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të hapni një horizont të ri për biznes personal.

LUANI

Për disa Luanë është koha për triumfe. Ka gjasa që ndërkohë që po shënoni sukses në profesion, do të fitoni edhe ndaj një rivali në dashuri. Gjithashtu, mund t'ju rriten edhe financa. Fitoret mund t'ju sjellin si gëzim ashtu edhe stres.

VIRGJERESHA

Problemi kryesor për Virgjreshat do të jetë mungesa e mbështetjes së duhur. Mos u mbështesni tek të afërmit, kolegët apo miqtë, pasi asnjë prej tyre nuk do të ketë mundësi t'ju ndihmojë. Përpunoni të bëni ballë vetë këtyre problemeve dhe të gjeni zgjidhje për to.

PESHORJA

Peshoret nuk do të marrin për bazë këshillën e dikujt. Përpara se të mendoni qëllimin negativ të fjalët e të tjerëve, përpunoni të jeni më të arsyeshëm. Kjo e martë është dita e duhur për të nisur një partneritet të ri në biznes ose për të nisur një marrëdhënie të re dashurie.

AKREPI

Akrepët duhet të mendohen më shumë përpara se të veprojnë. Ndoshta nuk duhet të mendoni keq për çdo gjë që ndodh rreth jush. Përpunoni të jeni më të sjellsëm. Shumë gjëra mund të ndryshojnë brenda ditës. Tregohuni më pozitiv. Akrepët e martuar duhet të jenë më romantikë.

SHIGJETARI

Disa Shigjetarë duhet t'i përkushtohen zhvillimit të ideve të reja. Ndoshta, kjo mund të ketë të bëjë me një projekt që ka qëllim luftën ndaj padrejtësive. Kur të promovoni këtë projekt, mos neglizhoni jetën personale.

BRICJAPI

Disa Bricjapë do të mund të rrisin autoritetin në punë ose të shënojnë sukses në biznes. Sa i përket marrëdhënieve personale, fati përjashtohet nga çdo mundësi. Mos u afroni me dikë të seksit të kundërt, që e njihni shumë pak.

UJORI

Për disa ujorë kjo do të jetë një periudhë produktive. Mund të fitoni mbështetje nga persona jo familjarë. Ata që janë në kërkim të një pune do të gjejnë disa njëkohësisht. Mendohuni mirë para se të zgjidhni, në mënyrë që të shmangni ndonjë gabim.

PESHQIT

Peshqit mund të suprizohen sot nga një vizitë e papritur. Mund të bëhet fjalë për dikë që e keni fshirë nga lista e kontakteve. Mos u mashtroni nga përpjekjet e tij/saj për t'ju bindur. Kjo këshillë vlen për të gjitha fushat e jetës. Mos ndryshoni asgjë në profesionin tuaj.

KAMPIONATI

Jo vetëm titull dhe mbi jetesë, një garë edhe më e rëndësishme zhvillohet për një vend në Kupat e Europës. Champions League, eliminatorët, është e prenotuar nga Partizani, i gjithë diskutimi tashmë bëhet për 3 biletat në Europa League, një nga Kupa dhe dy nga kampionati. Aktualisht Kukësi është ekipi më i favorizuar, ndodhet në vendin e dytë, plus 3 pikë nga Flamurtari,



por gjithashtu ka edhe një tjetër opsion, Kupën e Shqipërisë, pasi është kualifikuar në fazën gjysmëfinale. Më në fund verilindorët duken të bindur se titulli është i pamundur dhe janë të fokusuar të blindojnë vendin e dytë në kampionat dhe t'i shkojnë deri në fund Kupës. Në vendin e tretë është Flamurtari. Vlonjatët shpresojnë shumë të qëndrojnë në këto pozita deri në fund, pasi kampionati është

**Titull-Europë-mbijetesë,
Superliga luftë në tri fronte**

rruga e vetme që i siguron Europën, gjithashtu bëjnë tifo edhe për Kukësin, pasi nëse Kukësi fiton Kupën, lirohet edhe një vend tjetër në kampionat. Në vendin e 4-të me 46 pikë renditet Teuta, dy pikë më pak se Flamurtari. Në këtë fundsezon, Teuta ka humbur shumë nga

shkëlqimi i dy fazave të para. Europa tashmë nuk është në dorën e tyre. Gjithashtu, dy ekipe që vijnë të insistojnë për një vend në Europë janë Laçi dhe Skënderbeu. Kurbinasit duken të rilindur nën drejtimin e Starovës, me të drejtë besojnë ende te zona euro, pasi vendi i tretë është

të vetëm 4 pikë larg. I ndryshëm është diskutimi për Skënderbeun. Europa për klubin korçar është e lidhur ngushtë me vendimin përfundimtar nga Gjykata e Arbitrazhit Sportiv. Nëse KAS zhvlerëson dënimin e dhënë nga UEFA, Skënderbeu ka ende dy rrugë për të kapur Europën, nga Kupa ku janë në gjysmëfinale, por edhe nga kampionati, pasi janë 5 pikë larg vendit të tretë.



Jeton Selimi

Të dielën presidenti e kishte kritikuar drejtorin sportiv, u fol se do i hiqte disa kompetenca

**Lotito zbutet ndaj Tares:
Igli, një zgjedhje e zgjuar**

Kreu i klubit shpërtheu përpara stërvitjes

Kanë qenë momente tensioni ditën e djeshme në Formelo, ku përpara seancës stërvitore, Klaudio Lotito, presidenti i Lacios, ka folur përpara të gjithë skuadrës dhe stafit duke mos kursyer asnjë. Nervozizmi i presidentit kishte të bënte me humbjen ndaj Kievos, një skuadër e cila ka rënë matematikisht nga kategoria, humbje që për Lacion rrezikon të kthehet në dështim sezonal, pasi mund të mos kualifikohet për në zonën e Ligës së Kampioneve. Mes të kritikuarve ka qenë edhe Igli Tare, ndërsa "Sportmediaset" shkruante që Lotito mund t'i hiqte shumë direktiva nga merkatotja drejtorit shqiptar dhe t'ia kalonte Anxhelos Perucit. Gjithsesi, gjërat duket se janë qetësuar në ditën e sotme, me Lotiton që rrefëson sesi nisi bashkëpunimi i tij me Igli. "Thoshin që kishte ardhur me gomone dhe e tallnin për këtë. Kam bërë një zgjedhje shumë të zgjuar. Ishte koha që do t'i rinovonim kontratën, erdhi në takim bashkë me proku-



ratorin e tij dhe i thashë: 'Shiko, nuk do ta rinovoj kontratën'. Ai më tha: 'Si? Ju më keni dhënë fjalën, nuk është korrekte, nuk është serioze'. Ia thashë se kisha në plan ta bëja drejtor sportiv. 'Po si, nuk kam as licencën', - u përgjigj ai. 'Mos u shqetëso, - vazhdova - atë do ta marrësh. Mendohu për 30 minuta!' Erdhi pas gjysmë ore dhe më tha 'po'. Telefonata e parë që mora ishte ajo e Delio Rosit, i cili më pyeti nëse e kisha zgjedhur drejtorin sportiv. Ai thashë 'po' dhe ai më pyeti 'Rrezik ke zgjedhur Taren'. 'Po, kam zgjedhur Taren', - iu përgjigja. 'Ti e bën këtë, sepse e di që ai

është kundër meje', - vazhdoi Rosi dhe aty shpërtheva 'Si guxon të më flasësh kështu? Ti je një nëpunës, bëj punën tënde dhe pas dy muajsh do të më falënderosh'. Pas pak kohësh shkuam në Siena dhe u mundëm 2-0. Delio Rosi i tha Tares: 'I thuj presidentit të më shkarkojë, nuk e kam më skuadrën nën kontroll'. Tare më tregoi gjithçka dhe më fund më tha: 'President, unë do ta kisha mbrojtur'. Unë i thashë menjëherë: 'Po, ke të drejtë, ta mbrojt! Atë vit fituam Kupën e Italisë', - ka rrefyer presidenti i Lacios, Lotito gjatë një eventi në Kampjano të Romës.

VIJOJNË PUNIMET

Montohet impianti elektrik tek "Arena Kombëtare"

Në daljen e tij të fundit publike, presidenti i FSHF-së, Armand Duka deklaroi se "Arena Kombëtare" do të jetë gati për ndeshjen e 11 qershorit kundër Moldavisë, duke bërë kështu edhe inaugurimin zyrtar të impiantit më modern futbollistik në Shqipëri. Kjo deklaratë siç duket ka vënë nën presion kompaninë e ndërimitit, ndërsa ditë pas dite stadiumi i ri i kryeqytetit po merr formën e tij ideale. Dje në stadium ka nisur montimi i impiantit elektrik, që ndryshe nga stadiumet aktuale që janë të pajisura me to, nuk do të qëndrojnë në 4 kolona, por do të vendoset në pjesën e sipërme të tribunave, çka do të lejojë që të ndriçohet çdo kënd i fushës.



SULMUESI I PSG

Mbape sfidon Bolt, vrapon me 38 km/h

Jo vetëm festa për titullin e fituar, kurorëzuar me një tregolësh. Ndeshja kundër Monakos, për Mbape do të mbahet mend edhe për një shpejtësi të jashtëzakonshme. Sulmuesi i Paris Sën Zhermenit ka vrapuar aq shpejt sa të gjithë kanë nisur krahasimet me Usain Boltin, rekordmbajtësi i 100 metrave me 9'58. Në këtë rekord, sprinteri xhamajkan arriti një shpejtësi mesatare prej 37.58 km/h, që është më e ulët sesa ajo që arriti lojtari i Kombëtares franceze, në aksionin që solli golin e parë. Në fakt, krahasimi mes të dyve nuk është i barabartë. Bolt në rekordin e tij të regjistruar në Botërorin e vitit 2009 në Berlin, nisej nga piketat dhe arrinte një shpejtësi prej 44.72 km/h. Por gjithsesi koha e Mbapes prej 38 km/h mbetet e jashtëzakonshme për një sportist që nuk kryen një stërvitje të një discipline specifike.




Në më pak se 30 minuta

PSG shet në kohë rekord fanellat "Notre-Dame"

Të veshura nga lojtarët e PSG-së në përballjen e së dielës ndaj Monakos, që u fitua nga kryeqytetasi me rezultatin 3-1, fanella kushtuar katedrales së Notre-Dame është nxjerrë në shitje nga klubi parizien gjatë zhvillimit të ndeshjes. 1000 fanellat honorifike (500 në sajtin në internet të PSG, 250 në Megastore pranë stadiumit "Parc des Princes" dhe 250 në dyqanin në Champs-Élysées) janë shitur për publikun me çmimin 100 euro secila. Shitja ka zgjatur më pak se 30 minuta, me fanellat që kanë "avulluar" të gjitha, ndërsa paratë e grumbulluara nga kjo shitje do të shkojnë të gjitha për repartin e zjarrfikësve të kryeqytetit francez.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomie e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriotik bibli.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.

32. Ekstre në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.
34. Steiger aktor.
35. Inicialet e Delon.
37. Eshhtë edhe ai Me Gropa.
38. Një mund të jetë autonon.
40. Në krye të evidencës.
42. Edgar Allan Poe.
44. Ekstremet në litar.
46. Giorgio i modës.
50. Janë malet me Akonkagua.
52. Janë ujërat e bregdetit tonë.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.
10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.

11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibustierët.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një brejtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipò
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitor i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.


VERTIKAL

34. Neill i Jurassic park.
35. E bukura e belle epoque.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rocsktar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor


7. Kompozoi Mefistofele
8. Në radhë të parë.
9. Qytet zviceran
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstre në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërore
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lempër, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9		3		5	
	8	5	1	6	
		1		2	
5	9			7	
		4		9	
			3		1
			4		8
		6		3	7
			5	2	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	4	6	9	7	5	2	3	1
9	3	1	4	8	2	5	6	7
7	2	5	1	3	6	8	9	4
1	5	4	6	9	3	7	2	8
3	6	7	8	2	1	4	5	9
2	8	9	5	4	7	3	1	6
4	7	3	2	6	9	1	8	5
5	9	8	3	1	4	6	7	2
6	1	2	7	5	8	9	4	3

Argëtim filozofik

- Heshnja e bën bisedën reale midis miqve. Ajo që ka rëndësi nuk është të flasësh, por të mos kesh nevojë për të folur.

- Kurrë mos ndiej keqardhje për atë që keni menduar për gruan tënde. Ajo ka menduar shumë më keq për ju.

- Vetëm një në 1000 burra bëhet lider. Pjesa tjetër 999 ndjekin gratë.

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

17	1	8	4	2	4	13	1	13	1	E	L	E	K	T	R	I	K	K	U	R	A		
18	3	1	4		18	3		17	13	1	T	E	R	R	E	N	I	K	A	N	A	L	
8	1	10		10	10	1	5	1	6	12	6	I	R	M	A		F	O	N	I	K	E	
3		1	10	2	3	6	14	1	12	2	4	K	A	V	I	K	T	I	M	A	T	K	
	13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2	A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	S	
15	9	6	15	1	12	4	6		6	3	3	M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	A	
17	2	4	5	12		2	14		17	5	1	R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	Z	N
	8	1	7	6	3	1	10	1		2		C	E	N	E	D	A	T	I	K	O	N	
1	5	5	12		4	6	4	18	7	7	1	E	N	E	D	A	T	I	K	O	N	E	
1	3	2	8		1	5			2	12	2	E	T	E	R	O	L	A	Z	A	R		
20	19		1	5		20	5	4	6	10	2	T	O	E	A	F	A	T	A	L			
6	1		10	2	3	2	12	15	18	2	8	A	R	K	I	V	A	T	D	A	K	E	T

- - Një idiot mund të bëjë më shumë pyetje
- në një minutë se sa dhjetë burra të
- mençur mund të përgjigjen në një orë.
- - Një njeri i mençur mëson shumë nga
- një budalla, dhe një budalla nuk
- mëson asgjë nga një i mençur.
- - Të pamartuarit dinë më shumë për
- gratë se sa të martuarit. Nëse nuk
- dinin, do të ishin dhe ata të martuar.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

ARTET KAMPULA
REALE HARRI
ORKESTRAN
MTHERRIMET
AKTHESMERET
TURHAMES
SECIILINMOTET
MADAMEAKOMAA
IRONIATOMET
TINA BLITELI
ETDIANANTENA
PAKIGAPALLATE
RUUDERAAHRETT
OTLPKRPRTIMO
VOLAAMATORIPN
ORASATIRERT
KEVASHATBELLA
ATLANEKARRAP
TARLESERHARRK
ROTOVERTIBANOT
EMUTEMEZEROT
TAPANEELLYTIM

FJALËKRYQI (2)

